

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 5994  
E mërkurë, 5 shkurt 2020  
çmimi 0.40 €

## 1 500 raste të reja me kancer në Kosovë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

ALBIN KURTI ZYRTARISHT TË MARTËN KA PRANUAR POZITËN E KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS

FAQE 4-5

# KURTI: QEVERISJA JONË, PASQYRË NË TË CILËN QYTETARËT E SHOHIN VETVETEN



Me ceremoni zyrtare, Albin Kurti, fituesi i zgjedhjeve të 6 tetorit, ka pranuar të martën detyrën e kryeministrit të Republikës së Kosovës. Pas pranimit-dorëzimit të detyrës, Kurti ka thirrur mbledhjen e parë solemne të

kabinetit të vet, në të cilën u ka treguar ministrave se çfarë duhet të bëjnë. Ai u ka thënë ministrave të mos rrinë ulur në kolltukë e të urdhërojnë nga lart, por të zbresin sa më afër qytetarëve. Kryeministri Kurti ka

deklaruar se qeverisja e tyre është pasqyrë në të cilën qytetarët e shohin vetveten. Në ditën e tij të parë të punës në krye të qeverisë, Kurti ka bërë homazhe te Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz

## OPINION

ZARET U HODHËN, A PO KALOHET RUBIKONI PËR TË SHPËTUAR APO PËR T'U FUNDOSUR?!

F. 10-11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## AKTUALE



HIQET FOTOGRAFIA E PRESIDENTIT THAÇI, ZËVENDËSOHET ME ATË TË RUGOVËS

F. 3

## EKONOMI

ODAT EKONOMIKE, QEVERISË SË RE: TË KETË LËVIZJE PËRPARA NË AGJENDËN E REFORMËS SË BIZNESIT

F. 9

PËRGJEGJËSIA SOCIALE KORPORATIVE, E RËNDËSISHME PËR QËNDRUESHMËRINË E BIZNESEVE

F. 9



## SPORT

MELIZA DHE MUZA E SAJ, DY ZONJAT M. M.

F. 13

Kosovare KRASNIQI

## GRENELLI I KËRKON QEVERISË SË RE TA HEQË TAKSËN

I dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, i ka bërë thirrje Qeverisë së re të Kosovës që ta heqë taksën ndaj mallrave të importuara nga Serbia. Grenell, i cili është edhe ambasador i Shteteve të Bashkuara në Gjermani, ka thënë se pret që taksat të hiqet menjëherë. "Ne ua kemi bërë të qartë të gjithë udhëheqësve të partive në Kosovë që heqja e tarifave ishte në interesin më të mirë të Kosovës dhe ekonomisë së saj si dhe synimeve për të tërhequr biznese të reja", ka thënë Grenell

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Basha takon ambasadorin e ShBA-së, paralajmëron zhvillime politike

**TIRANË, 4 SHKURT** - Kreu i Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha, ka pritur të martën në selinë e PD-së ambasadorin e re të ShBA-së në Tiranë, Yuri Kim. Pas takimit, në një prononcim për mediet, Basha

ka paralajmëruar zhvillime dhe lajme politike. Basha tha se çdo zhvillim ka të bëjë me qëllimin e PD-së për të nxjerrë vendin nga kriza e rëndë politike. "Dita e zhvillimeve politike sot dhe atyre që do të vijnë

do të jetë plot me lajme, me prioritete, me zhvillime. Për një gjë ju siguroj, se gjithçka që po bëhet, po bëhet për t'i shërbyer një qëllimi që shkon përtej Partisë Demokratike dhe opozitës, qëllimi për t'u dhënë

shqiptarëve një rrugë shprese dhe dalje nga kriza. Kështu që në këtë kuptim ndjehem i inkurajuar nga takimet sot dhe do të vazhdoj t'ju mbaj të informuar", deklaroi kreu i PD-së, Lulzim Basha.



## Procesi i zgjerimit të BE-së dhe Ballkani Perëndimor

Ndryshimet që Komisioni do t'i shpalosë do t'ua japin vendeve anëtare fuqinë për ta ndaluar procesin e pranimit të vendeve të reja ose, madje, edhe detyrimin e vendeve që t'i rifillojnë bisedimet e anëtarësimit në disa fusha



që tashmë janë anëtare të bllokut. Zyrtarët e BE-së thonë se një veprim i tillë do të rrezikonte mbështetjen për zgjerimin midis vendeve anëtare të varfra.

Një diplomat i BE-së tha që ende nuk ishte e qartë nëse Franca do të jetë e kënaqur me propozimet e reja. "Me presidentin Macron, ne kemi një shans prej 60 për qind për sukses", tha ai.

Të gjitha qeveritë e tjera të vendeve të Bashkimit Evropian gjithashtu duhet të pajtohen me metodologjinë e re.

Zyrtarët francezë në Paris i thanë agjencisë së lajmeve Reuters, se nuk i kanë parë ende propozimet e Komisionit, por kanë zhvilluar bisedime me Komisionarin evropian të Zgjerimit, Oliver Varhelyi.

Vende të tjera, përfshirë Holandën dhe Danimarkën, gjithashtu kanë qenë skeptikë për zgjerimin, por zyrtarët e BE-së thonë që nëse ata mund ta bindin Francën të heqë dorë nga kundërshtimet e saj, ato vende me siguri do të pajtoheshin.

**BRUKSEL, 4 SHKURT** - Komisioni Evropian do të propozojë ndryshime në sistemin e pranimit të vendeve të reja në Bashkimin Evropian, duke u dhënë më shumë zë vendeve anëtare, në një përpjekje për ta zbutur qëndrimin e Francës, e cila i vuri veto zgjerimit të bllokut me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në tetor të vitit të kaluar, presidenti francez Emmanuel Macron ndërpreu procesin e pranimit të Serbisë, Kosovës, Malit të Zi, Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës Maqedonisë së Veriut. Komisioni shpreson ta bindë Francën të heqë dorë nga kundërshtimet e saj para takimit të lartë të Zagrebit me vendet e Ballkanit në muajin maj.

Presidenti Macron është bërë më i zëshmi midis politikanëve evropianë që thonë se zgjerimi i fundit i madh, kur Rumania dhe Bullgaria u anëtarësuan në vitin 2007, ishte shumë i nxituar dhe nevojitet kujdes për shtimin e më shumë vendeve anëtare nga një rajon i përfshirë nga korrupsioni dhe krimi.

Në nëntor, Franca dorëzoi një propozim për ndryshime, që do t'ua jepnin udhëheqësve të vendeve anëtare më shumë zë mbi procesin e zgjerimit. Parisi thotë se mbështet anëtarësimin e vendeve të Ballkanit në një afat të gjatë, ka njoftuar voa.

Ndryshimet që Komisioni pritet t'i shpalosë të mërkurën, do t'ua japin vendeve anëtare fuqinë për të ndaluar procesin e pranimit të

vendeve të reja, ose madje edhe detyrimin e vendeve që të rifillojnë bisedimet e anëtarësimit në disa fusha. Më shumë takime të nivelit të lartë do të mbaheshin në rajonin e Ballkanit për t'u dhënë politikanëve mundësi që të flasin më shumë përgjatë procesit. "Presidenti Macron dëshiron të shihet si 'lojtar kryesor' dhe ne mund ta pranojmë këtë, sepse

besueshmëria e BE-së është në pikëpyetje", tha një zyrtar i lartë i BE-së i përfshirë në reformë. "Kjo është politike dhe personale, kështu që le ta shmangim dramën", tha ai. Por propozimet e Komisionit nuk do të përmbushin disa nga kërkesat franceze, përfshirë edhe atë që fondet për anëtarët e rinj të merren nga paratë e përcaktuara për vendet e varfra

## Haradinaj në Senatin amerikan flet për sigurinë e telekomunikimit



**PRISHTINË, 4 SHKURT** - Ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në një forum në Senatin amerikan, ku është diskutuar për nevojën e ngritjes së kapaciteteve për të qenë më të fortë në mbrojtje nga kërcënimet e sigurisë dhe influencës së Kinës dhe Rusisë në sistemet e telekomunikimit. Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se Kosova nuk ka rënë pre e kësaj influence pasi ka refuzuar investimet kineze dhe ruse në fushën e

telekomunikimit. "Sot në Senatin amerikan, mora pjesë në forumin e organizuar nga senatori Inhofe, kryesues i Komitetit për Shërbimet e Armatosura dhe gjenerali Jim Jones, rreth temës së kërcënimeve ndaj sigurisë duke përfshi edhe atë kibernetike. Në këtë forum, mes senatorëve dhe kongresistëve të ShBA-së si dhe udhëheqësve nga Evropa Juglindore, diskutuam për nevojën e ngritjes së kapaciteteve për të qenë më të

fortë në mbrojtje nga kërcënimet e sigurisë dhe influencës së Kinës dhe Rusisë në sistemet e telekomunikimit.

Siguria vjen e para! Kosova nuk ka rënë pre e kësaj influence pasi ka refuzuar investimet kineze dhe ruse e veçanërisht ka refuzuar kompanitë kineze në fushën e telekomunikimit dhe 5G. Kosova me krenari është rreshtuar në krah të ShBA-së dhe partnerëve të saj dhe ky qëndrim i qartë forcon partneritetin dhe miqësinë", ka shkruar Haradinaj.

## Maqedonia e Veriut pret që në mars të ratifikohet pranimi i saj në NATO

**VARSHAVË, 4 SHKURT** - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, tha se pret që Spanja - vendi i fundit që duhet ta ratifikojë pranimin e vendit të tij në NATO - ta bëjë një gjë të tillë në muajin mars. "Nëse gjithçka shkon sipas planit, ky proces

duhet të përfundojë rreth datës 10 mars. Pastaj do të mbeten disa detaje teknike që Parlamenti ynë në Shkup do të duhet t'i trajtojë", tha Pendarovski gjatë një vizite në Poloni.

Vendet anëtare të NATO-s, vitin e kaluar, kanë nënshkruar mar-

rëveshjen që i mundëson Maqedonisë së Veriut të bëhet anëtarja e 30-të e aleancës ushtarake.

Kjo ka ndodhur pasi Shkupi ka arritur një marrëveshje me Athinën për ndryshimin e emrit të shtetit. Vendi i fundit që duhet

ta ratifikojë pranimin e Maqedonisë së Veriut në NATO është Spanja dhe Pendarovski shfaqti shpresën se Madridi do ta bëjë një gjë të tillë muajin e ardhshëm.

Maqedonia e Veriut është në pritje të hapjes së negociatave të



anëtarësimit edhe me Bashkimin Evropian.

# Grenelli i kërkon qeverisë së re ta heqë taksën

I dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, i ka bërë thirrje Qeverisë së re të Kosovës që ta heqë taksën ndaj mallrave të importuara nga Serbia. Grenell, i cili është edhe ambasador i Shteteve të Bashkuara në Gjermani, ka thënë se pret që taksat të hiqet menjëherë. “Ne ua kemi bërë të qartë të gjithë udhëheqësve të partive në Kosovë që heqja e tarifave ishte në interesin më të mirë të Kosovës dhe ekonomisë së saj si dhe synimeve për të tërhequr biznese të reja”, ka thënë Grenell

## “Epoka e re”

**PRISHTINË, 4 SHKURT** - Ambasadori Richard Grenell, i dërguar i presidentit Donald Trump për bisedimet Kosovë - Serbi, i ka bërë thirrje të martën Qeverisë së Kosovës që t'i heqë tarifën ndëshkuese ndaj mallrave serbe që kanë bllokuar procesin e bisedimeve ndërmjet të dyja vendeve ballkanike.

Grenell, i cili është edhe ambasador i ShBA-së në Berlin, ka thënë se taksat duhet të hiqet menjëherë. “Ne ua kemi bërë të qartë të gjithë udhëheqësve të partive në Kosovë që heqja e tarifave ishte në interesin më të mirë të Kosovës dhe ekonomisë së saj si dhe synimeve për të tërhequr biznese të reja”, ka thënë ai në një deklaratë dërguar nëpërmjet postës elektronike për agjencinë e lajmeve “Associated Press”.

Ambasadori Grenell muajin e kaluar ndërmjetësoi një marrëveshje për vendosjen e linjës ajrore ndërmjet të dyja

vendeve pas 21 vjetësh dhe hapi diskutimet për rihapjen e linjës hekurudhore ndërmjet tyre. “Ne po shënojmë përparim historik”, ka pohuar ambasadori Grenell. “Ka shumë të reja që do të publikohen së shpejti sepse të dyja palët duan të ecin përpara. Këto lëvizje do të krijojnë një jetë më të mirë për njerëzit e rajonit”, është shprehur ai.

Ditë më parë, gjatë një vizite në rajon, i dërguari amerikan për bisedimet Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka theksuar Kosova duhet ta heqë taksën, ndërsa Serbia duhet t'i japë fund fushatës për tërheqjen e njohjeve të pavarësisë së Kosovës.

Të martën edhe shefi i politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka mirëpritur formimin e qeverisë së re të Kosovës, të drejtuar nga Albin Kurti, ndërsa ka theksuar se pret intensifikimin e diskutimeve lidhur me bashkëpunimin ndërmjet BE-së dhe Kosovës, reformat dhe bisedimet e lehtësuara nga



Bashkimi Evropian ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “Bashkimi Evropian mbetet i përkushtuar për punë me institucionet dhe qytetarët e Kosovës në rrugën evropiane. Ka shumë punë përpara për qeverinë e re për t'i përmbushur detyrimet nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, agjendën e reformave evropiane, sundimin e ligjit dhe zhvillimin ekonomik. Bashkëpunimi rajonal duhet të forcohet sikurse edhe marrëdhëniet e mira fqinjësore. Në këtë kuadër presim rifillimin e shpejtë të bisedimeve ndërmjet Beogradit e Prishtinës të lehtësuara nga Bashkimi Evropian për normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve. Gjendja aktuale nuk është e qëndrueshme. Nuk ka asnjë alternativë për një

rifillim të shpejtë të bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës”, thuhet në njoftimin e Borrellit. Ai ka kërkuar edhe riangazhimin e Kosovës në nismat rajonale në dobi të saj. “Sfidat me të cilat përballlet Kosova janë të mëdha, por të tilla janë edhe mundësitë e Kosovës. Ne jemi të gatshëm ta ndihmojmë Kosovën në agjendën evropiane të reformave dhe ta vazhdojmë mbështetjen tonë në forcimin e sundimit të ligjit për të gjithë, përmirësimin e administratës publike për të ofruar shërbime që qytetarët i meritojnë, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike”, thuhet në njoftimin e zyrës së Borrellit.

Në fund të vitit 2018 Qeveria e atëhershme e Kosovës, në krye

me Ramush Haradinaj, u ka vënë taksë 100 për qind importeve nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Menjëherë pas vënies së kësaj takse është ndërprerë dialogu për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. Kjo taksë nuk është hequr edhe përkundër thirrjeve të komunitetit ndërkombëtar për ta bërë një gjë të tillë.

Kryeministri i ri i Kosovës, Albin Kurti, i cili është zgjedhur në këtë detyrë të hënën, ka thënë se është i gatshëm për vazhdimin e dialogut me Serbinë dhe ka paralajmëruar formimin e një ekipi gjithëpërfshirës për këtë proces. Kurti, po ashtu, ka thënë se është i gatshëm të ndërmarrë masa reciproke tregtare, ekonomike dhe politike ndaj Serbisë.

## 1 500 raste të reja me kancer në Kosovë

**EPOKA E RE**

**Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 4 SHKURT** - Klinika e Onkologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka publikuar raportin e punës me rastin e shënimit të Ditës Botërore Kundër Kancerit.

Drejtori i Onkologjisë, Ilir Kurtishi, ka thënë se gjatë vitit 2019 janë regjistruar 1 586 raste të reja me kancer në Kosovë. Duke i paraqitur në mënyrë tabelore, Kurtishi ka thënë se dominon kanceri i gjirit dhe kanceri në mushkëri. “30-35 gra në muaj janë diagnostikuar me kancer të gjirit. Brenda vitit janë paraqitur 378 raste të reja. Kanceri i mushkërive më së shumti ka prekur gjininë mashkullore, me një numër prej 228 rastesh”, ka thënë Kurtishi.

Në bazë të regjistrave të punës, me kancer gastrointestinal janë paraqitur 352 raste, me kancer urogjenital/gjinekologjik 390, me kancer në kokë dhe qafë 237 dhe me kancer gastrointestinal 352 raste.

Gjatë vitit 2019 Klinika e Onkologjisë ka ofruar 217 mijë e 143 shërbime të kimioterapisë, ndërsa sa i përket radioterapisë, janë ofruar 26 mijë shërbime në kujdesin paliativ dhe kurativ.

Kryetari i Shoqatës së Oftamologëve, Arben Bislimi, ka thënë se 1/3 e sëmundjeve të kancerit mund të parandalohet nëse trajtohet me kohë. “9.6 milionë njerëz vdesin nga kanceri në botë. 1/3 e kësaj sëmundjeje mund të parandalohet me trajtimin e hershëm. Gjithmonë do ta ofrojmë asistencën tonë sepse vetëm bashkë mund t'ia



dalim”, është shprehur Bislimi. Nafije Latifi, themeluesja e Shoqatës “Jeta Vita”, njëherësh edhe paciente që i mbijetoi kancerit, rrëfeu situatën në të

cilën gjendet një pacient me këtë sëmundje. “E di se në çfarë situatë kalon një pacient. Synimi ynë ka qenë vetëdijesimi i grave. Është mirë të paraqiten te mjeku.

Paraqitja e hershme e lehtëson trajtimin. Nëse realizohen synimet e Onkologjisë, atëherë pacientët do të jenë të kënaqur me trajtimin”, ka thënë Latifi.

Albin Kurti zyrtarisht të martën ka pranuar pozitën e kryeministrit të Kosovës

# Kurti: Qeverisja jonë, pasqyrë në të

Me ceremoni zyrtare, Albin Kurti, fituesi i zgjedhjeve të 6 tetorit, ka pranuar të martën detyrën e kryeministrit të Republikës së Kosovës. Pas pranim-dorëzimit të detyrës, Kurti ka thirrur mbledhjen e parë solemne të kabinetit të vet, në të cilën u ka treguar ministrave se çfarë duhet të bëjnë. Ai u ka thënë ministrave të mos rrinë ulur në kolltukë e të urdhërojnë nga lart, por të zbresin sa më afër qytetarëve. Kryeministri Kurti ka deklaruar se qeverisja e tyre është pasqyrë në të cilën qytetarët e shohin vetveten. Në ditën e tij të parë të punës në krye të qeverisë, Kurti ka bërë homazhe te Kompleksi Memorial “Adem Jashari” në Prekaz



**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 4 SHKURT** - Kryeministri i ri, Albin Kurti, edhe zyrtarisht e ka marrë pozitën të martën. Në hyrje të ndërtesës së Qeverisë së Kosovës ai është pritur nga Garda Ceremoniale e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ku është intonuar himni i Kosovës. Në mungesë të ish-kryeministrit Ramush Haradinaj, pritjen ceremoniale dhe dorëzimin e detyrës Kurtit ia ka bërë ish-zëvendëskryeministri i parë, Behgjet Pacolli.

Ky i fundit, duke e vlerësuar këtë ditë si të jashtëzakonshme për Kosovën, i ka uruar suksese në punën e tij kryeministrit të ri. “Ne e kemi edhe një raport të cilin do t’jua dorëzoj. Do të ishte mirë që këtë ta bënte z. Haradinaj, por meqenëse ai nuk është këtu, më ka autorizuar mua që të jem unë ai që e dorëzon detyrën. Ju

dëshiroj suksese të mëdha, shëndet, lumturi dhe punë të mbarë”, ka thënë Pacolli teksa ia ka dorëzuar raportin e punës kryeministrit të ri.

Pas pranim-dorëzimit të detyrës, kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka falënderuar Pacollin për pritjen zyrtare, duke thënë se raportin qeverisës do ta lexojë me kujdes. “Unë mbrëmë kam biseduar me kryeministrin Haradinaj i cili ndodhet në ShBA dhe kthehet në fundjavë. Pastaj do të takohemi edhe me të dhe ta mbajmë komunikimin e bashkëpunimin tonë”, është shprehur Kurti.

## Kurti mban mbledhjen e parë të qeverisë

Pas pranimit-dorëzimit të detyrës, Kurti ka thirrur mbledhjen e parë të kabinetit qeveritar, i cili përbëhet nga 15

ministra dhe dy zëvendëskryeministra. Ai ua ka bërë me dije vartësve të vet se ky kabinet është i qytetarëve dhe se ata duhet të punojnë në emër të tyre e për ta. “Ata na kanë dhënë neve besimin, na kanë dhënë mandatin dhe presin nga ne që t’i realizojmë prioritetet dhe detyrat tona. Energjia dhe entuziazmi i qytetarëve duhet të jenë motor

për punën tonë, prandaj edhe nuk mund të pushojmë derisa ta shpërblejmë besimin e tyre. 100 ditët e para do të jenë ditët të zëna me angazhim e përkushtim maksimal. Karriget i kemi, por jam i bindur se më shumë do të rrimë në këmbë për shkak të punëve të shumta që na presin”, ka thënë ai.

Kurti ka treguar se programi

qeverisës është ambicioz aq sa janë edhe pritjet e qytetarëve. “Unë s’kam dyshim se ne kemi aftësinë, guximin dhe shkathtësitë për t’i dhënë rezultatet të cilat kërkohen prej nesh. Sytë e gjithë popullit tashmë janë te ky kabinet qeverisës, rrjedhimisht te secili prej jush. Do të ishte mirë që të gjithë ne ta mësojmë përmendësh programin tonë që del nga marrëveshja jonë e përbashkët sepse me të do të zgjohemi në mëngjes e me të do të flemë në mbrëmje. Le të bëhemi të thjeshtë e të drejtë ashtu siç i kemi qytetarët tanë që janë aq të mirë. Ministri i Bujqësisë duhet të kalojë më shumë kohë me fermerët sesa në zyrën e tij, e ministri i Shëndetësisë më shumë kohë duhet të kalojë me mjekë e me pacientë. Pra, jo të rrimë ulur në kolltukë e të urdhërojmë nga lart, por të zbresim poshtë e sa më afër te qytetari sepse atje është e vërteta jonë, atje shihen politikat tona”, është shprehur ai, duke shtuar se mandatin duhet ta kuptojnë si privilegj për të shërbyer, jo për të urdhëruar. I pari i qeverisë i ka ftuar vartësit e tij që t’i japin kuptim pozitës së ministrit çfarë s’ka pasur asnjëherë në Kosovën e pasluftës. Sipas Kurtit, sukseset dhe dështimet janë kolektive dhe jo personale apo partiake. “Partitë i



# cilën qytetarët e shohin vetveten



rëndësishme për mua sesa realizimi i programit qeverisës dhe zbatimi i prioriteteve për qytetarët. Qëllimet i kemi të mira e dëshirat për suksese të mëdha. Energjitë e akumuluar në opozitë është koha t'i kthejmë në veprim në qeveri", ka deklaruar ai. Më tej, Kurti ka deklaruar se takimet mes tyre do të jenë të shpeshta e të shumta që ta koordinojnë punën dhe të rrisin bashkëpunimin mes vete, duke shtuar se puna e tyre është e ndërlidhur me njëri-tjetrin. "Mos të harrojmë se qeverisja jonë është pasqyrë në të cilën qytetarët e shohin vetveten. Le të jetë kjo një pamje të cilën ata duan ta shohin sërish e përsëri, duan ta shohin vazhdimisht. Unë ju falënderoj shumë për pjesëmarrjen në këtë mbledhje të parë ceremoniale e solemne, e më pastaj do të vazhdojmë një ditë tjetër me mbledhjen për programin dhe planin tonë të punës", ka përfunduar Kurti.

Kuvendi i Kosovës të hënën e ka votuar kabinetin qeveritar të Albin Kurti me 66 vota.

Po ashtu, të martën, pothuajse të gjithë ministrat kanë bërë pranim-dorëzimin e detyrës.

Ministri i ri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Glauk Konjufca, të martën ka pranuar detyrën nga ish-ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, i cili gjatë mandatit të kaluar qeverisës mbante njëherësh edhe pozitën e zëvendëskryeministrit të parë të Republikës.

Pas ceremonisë së dorëzimit-pranimit të detyrës ministrore, të mbajtur në sallën e konferencave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ish-ministri Pacolli dhe ministri Konjufca u prononcuan për media.

Ish-ministri Pacolli ka shprehur besimin e tij se ministri Konjufca do ta kryejë punën edhe mirë, edhe me përgjegjësi, ndërsa tha se do të vazhdojë të kontribuojë gjithmonë për shtetin e Kosovës.



kemi në parlament, atje janë grupet tona parlamentare, këtu punojmë si ekip. Në këtë qeveri nuk do të ketë LV, LDK, NDS e LS. Do të jemi Qeveria e Republikës së Kosovës që punon bashkë për të mirën e përbashkët. Në këtë drejtim dera ime është e hapur për çdo ditë, në çdo orë e në çdo minutë. Asgjë nuk është më e

## Ambasadori Kosnett, mysafiri i parë i Kurtit

Pas pranimi të detyrës, kryeministri Albin Kurti ka pritur të martën edhe mysafirin e parë. Ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ka qenë njeriu i parë që e ka vizituar zyrtarisht në zyrën e tij kryeministrit e vendit. Diplomati amerikan ka uruar Kurtin për marrjen e pozitës së kryeministrit, kurse mediet janë lejuar të marrin vetëm pamje. Gjithashtu, ambasadori Kosnett të martën ka vizituar edhe kryeparlamentaren Vjosa Osmani, së cilës ia ka uruar detyrën e re.

Edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme është mbajtur ceremonia e pranim-dorëzimit të postit të ministrit të Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike. Me këtë rast, ish-ministri Ekrem Mustafa i ka dorëzuar detyrën ministrit të ri të Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Agim Veliut.

Për herë të parë që nga formimi i institucioneve të Republikës së Kosovës, në qeverinë e re të

drejtuar nga Albin Kurti, që përbëhet nga 15 ministri, pesë prej tyre do të udhëhiqen nga gratë. Ndërkohë, në krye të Kuvendit të Kosovës është zgjedhur po ashtu një grua, Vjosa Osmani, e cila zëvendëse të parë ka një grua, deputeten Arbërie Nagavci.

Ministret gra të votuara të hënën në Kuvendin e Kosovës janë: Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë, Rozeta Hajdari, ministre e Ekonomisë, Tregtisë dhe Financave. Që të dyja nga Lëvizja Vetëvendosje. Ndërkaq, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Hykmete Bajrami është emëruar ministre e Arsimit dhe Vlorë Dumoshi ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kurse nga komunitetet joserbe, Emilia Rexhepi do të jetë ministre e Administrimit të Pushteti Lokal. Në qeverinë e udhëhequr nga Ramush Haradinaj, e formuar në vitin 2017 dhe e cila numëronte 21 ministri, fillimisht ishin emëruar vetëm dy gra në poste ministrore, Dhurata Hoxha dhe Albena Reshitaj. Kjo e fundit një vit më vonë kishte dhënë dorëheqje.

## Kurti bën homazhe në Prekaz



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në ditën e parë të punës në krye të qeverisë ka bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në

Prekaz. Në fjalën e tij para medieve, kryeministri Kurti ka thënë se liria që gëzon Kosova dhe shteti që ka, i ka rrënjët në sakrificën e heronjve, dësh-

morëve dhe martirëve të kombit e, mbi të gjitha, te flijimi i Jasharëve. "Në këtë vend 59 anëtarë të familjes së gjerë të Jasharëve dhanë jetën e tyre

në atë që e njohim si 'Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës', në krye me Komandantin Legjendar Adem Jashari. Unë sot e falënderoj

për mirëpritjen djalin e Hamëz Jasharit, kryetarin e Komunës së Skenderajt, Bekim Jasharin", ka thënë Kurti.



## Përkujtohen të rënët në masakrën e vitit 2000 në Mitrovicë

MITROVICË, 4 SHKURT (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri dhe në bashkëpunim me Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, është mbajtur të martën akademja përkujtimore kushtuar 20-vjetorit të masakrës së 3 dhe 4 shkurtit të vitit 2000, në të cilën ishin vrarë dhjetë shqiptarë, duke përfshirë femijë, gra e pleq.

Në këtë akademi ka marrë pjesë edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, nënkryetari i Mitrovicës, Faruk Mujka, drejtorë të drejtorive

komunale, asamblistë, familjarë të viktimave dhe një numër i shumtë i qytetarëve. Me këtë rast, kryeministri Albin Kurti ka thënë se në Mitrovicë edhe pas përfundimit të luftës nuk ka mbaruar lufta, pasi nuk janë ndalur luftimet dhe sulmet e ndryshme. "Mëngjesi i 4 shkurtit i gjeti banorët e Mitrovicës në një gjendje lufte, ku morën vesh se janë ekzekutuar 10 qytetarë të pafajshëm. Ne si shtet i Kosovës dhe si institucione iu kemi shumë borxh këtyre familjeve të cilat vuajtën edhe pas çlirimit. Ne duhet të qëndrojmë pranë



tyre, sepse kanë dhimbje e pikëllim të madh për familjarët e tyre", ka thënë Kurti.

Ndërsa kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, pasi ka

përhëndetur kryeministrin Kurti dhe pjesëmarrësit e tjerë për praninë e tyre në këtë akademi, ka ngushëlluar familjarët e viktimave për

tmerrin e ndodhur para 20 vjetësh, duke thënë se forcat e pushtetit serb kanë terrorizuar në banesat dhe shtëpitë e tyre shqiptarët e pafajshëm, të cilët nuk e kishin pritur një gjë të tillë. Më tutje, Bahtiri ka bërë me dije se Komuna e Mitrovicës do të ndërtojë së shpejti një shtëpi për familjen e Gani Xhakës, i cili ka humbur gruan gjatë masakrës së 3 dhe 4 shkurtit të vitit 2000.

Në fund të kësaj akademie, kryetari i Qendrës Rajonale të KMDLNJ në Mitrovicë, Halit Barani, ka folur me të dhëna të sakta për pasojat e krimit serb gjatë natës së 3 dhe 4 shkurtit.

## Kryetari i Pejës takohet me ambasadorin britanik, flasin për vazhdim të bashkëpunimit

PEJË, 4 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka pritur në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e fundit që janë duke ndodhur në këtë komunë. Kryetari Muhaxheri e ka falënderuar Britaninë e Madhe për gjithë atë që kanë bërë për Kosovën, duke vlerësuar në veçanti bashkëpunimin dhe mbështetjen që janë duke i dhënë Komunës së Pejës.



Në fund të takimit të dyja palët shprehën gatishmërinë për ta vazhduar bashkëpunimin edhe në të ardhmen.

## Nis renovimi i objektit të Qendrës së Mjekësisë Urgjente në Prishtinë

PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se në Qendrën e Mjekësisë Urgjente kanë filluar punimet për renovimin e tërësishëm të objektit dhe infrastrukturës përcjellëse. Për këtë arsye, kjo komunë ka treguar se ekipet e kësaj qendre janë rilokuar për ta vazhduar punën dhe shërbimin ndaj qytetarëve. "Drejtoria dhe administrata janë vendosur në Qendrën e Mjekësisë Familjare 5, ndërsa ekipet e mjekëve të mjekësisë urgjente janë në Qendrën Kryesore të



Mjekësisë Familjare dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare 4, 5 dhe 11. Numri i thirrjes për rastet emergjente mbetet i njëjti, 194", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.

## AQH-ja zvicerane vazhdon ta mbështesë shëndetësinë e Malishevës



MALISHEVË, 4 SHKURT (ER) - Organizata zvicerane Accesible Quality Healthcare (AQH) do të vazhdojë ta mbështesë shëndetësinë në Malishevë edhe në katër vjetët e ardhshëm. Kjo është bërë me dije të martën gjatë një takimi të udhëheqësit të AQH-së në Kosovë, Nicu Fota, me kryetarin e Malishevës, Ragip Begaj, nënkryetarin Hajdin Berisha, drejtorin e Shëndetësisë, Liridon Hoti, dhe drejtorin e QKMF-së, Nuhi Morina. Në këtë takim, Fota ka thënë se AQH-ja do

të vazhdojë ta mbështesë shëndetësinë në Malishevë në kuadër të projektit të tyre për mbështetje në sektorin e shëndetësisë në disa nga komunat e Kosovës. "Do të vazhdohet edhe me fazën e dytë të këtij projekti, sepse faza e parë e projektit ka shkuar shumë mirë dhe bashkëpunimi ka qenë i shkëlqyeshëm me komunën dhe QKMF-në", ka thënë Fota. Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka falënderuar përfaqësuesin e

AQH-së për realizimin e projektit gjatë katër vjetëve të kaluara si dhe për vazhdimin e projektit në fjalë. "Ne kemi nevojë për përkrahje në shëndetësi dhe ju falënderojmë për përkrahjen e vazhdueshme", ka thënë Begaj. Projekti i AQH-së është i orientuar në tri pika, duke filluar me ofrimin e shërbimeve më të mira shëndetësore, pastaj fuqizimin dhe vetëdijesimin e qytetarëve për të drejtat në marrjen e shërbimeve shëndetësore dhe ngritjen profesionale.

## Komuna e Rahovecit shpërndan 301 motokultivatorë për fermerët rahovecianë



RAHOVEC, 4 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka bërë shpërndarjen e 301 motokultivatorëve për fermerët rahovecianë. "Nga kjo fazë

dhe nga fazat e tjera të shpërndarjes kanë përfituar motokultivatorë gjithsej 361 fermerë, të cilët do ta kenë më të lehtë t'i fillojnë punët e tyre përgatitore për këtë sezon dhe të kenë prodhimtari cilësore. Përkujtojmë faktin se në 6 faza të shpërn-

darjes, për 12 lloje të pajisjeve, veglave dhe të mekanizmit bujqësor, kanë përfituar 812 fermerë", ka thënë Latifi. Ai ka theksuar se Komuna e Rahovecit dhe Drejtoria e Bujqësisë do të vazhdojnë të jenë krah i fortë i bujkut.

# Hiqet fotografia e presidentit Thaçi, zëvendësohet me atë të Rugovës

Kryetarja e re e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se fotografia e presidentit Hashim Thaçi gjendet ende brenda zyrës, por asaj i është ndërruar vetëm vendi. “Në përputhje të plotë me ligjin fotografia e presidentit aktual ndodhet në kabinet, por vetëm është larguar në ballë. Është akoma brenda zyrave të Kuvendit”, ka thënë Osmani

**EPOKA  
ERE****Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 4 SHKURT** - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, me të marrë detyrën e re, në ditën e parë të punës, e ka hequr nga zyra e vet fotografinë e presidentit Hashim Thaçi. Ajo fotografinë e Thaçit e ka zëvendësuar me fotografinë e ish-presidentit Ibrahim Rugova. Fotografia e presidentit Thaçi ka qenë e vendosur në këtë pozitë kur Kadri Veseli për dy mandate ka ushtruar këtë funksion. Ndërrimi i fotografisë u pa të martën gjatë takimit që pati Osmani me ambasadorin e ShBA-së, Philip Kosnett.

Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka deklaruar për media se fotografia e presidentit Thaçi gjendet akoma përbrenda zyrës, siç tha ajo, se është ndryshuar vetëm vendi. Osmani ka potencuar se ligji për simbole nuk e përcakton se ku duhet të caktohet, por vetëm se ajo duhet të jetë vetëm brenda institucionit. “Ka arsye, se e njoh shumë mirë ligjin. Në përputhje të plotë me ligjin fotografia e presidentit aktual ndodhet në kabinet, por vetëm është larguar në ballë. Është akoma përbrenda zyrave të Kuvendit. Ligji për simbolet nuk e përcakton se ku duhet të caktohet, por vetëm brenda institucionit. Do të shihni se ku është bërë zhvendosja. Është një ndryshim, por assesi zhvendosje në shpërpushje me ligjin. Presidenti Rugova ka qenë figura politike që ka inspiruar dhe inspiron. Për më tepër, Rugova është arkitekti i shtetit”, ka thënë Osmani.

Ndaj këtij veprimi ka pasur reagime në rrjetet sociale edhe nga përfaqësues të PDK-së. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) përmes një reagimi për

media ka kërkuar që të kthehet fotografia zyrtare e presidentit. “Vjosa Osmani, e zgjedhur natën dhe me votat e Listës Srpska, ka shkelur rëndë ligjin NR. 03/L-132 për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës duke hequr fotografinë zyrtare të Presidentit. Zbatimi i ligjit nuk varet nga dëshirat e askujt, pavarësisht bindjeve politike dhe këtë gjë ajo duhet ta dijë mirë si eksperte dhe ligjëruese e jurisprudencës. Me veprimin e saj primitiv, kryekuvendarja e zgjedhur në mënyrë të dyshimtë, Vjosa Osmani, përfaqëson mentalitetin e vjetër që synon hakmarrjen dhe përçarjes së qytetarëve. Që në ditën e parë në pozitën e re, ajo po dëshmon se përfaqëson vetëm interesin e saj brenda partisë së vet dhe jo t’i shërbejë institucionit ku është zgjedhur”, thuhet në reagimin e PDK-së.

Ky subjekt politik ka vlerësuar se kanë dhënë shembull pas zgjedhjeve të 6 tetorit duke mbetur në opozitë dhe siguruar tranzicionin e pushtetit, por nuk do të tolerojë që të cenohet rendi kushtetues e ligjor dhe asnjë institucion i rëndësishëm i Kosovës. “PDK-ja është, po ashtu, duke shqyrtuar dhe analizuar anën legale të zgjedhjes së saj si kryetare natën e mbrëmshme. PDK-ja bën thirrje që kthimi i fotografisë së Presidentit të ndodhë sa më parë. Administrata e Kuvendit të Kosovës të reagoj pa vonesë, në të kundërtën, fotografia e presidentit do të rikthehet në pozitën e vet me çdo kusht, si ruajtje e karakterit kushtetues dhe sovranitetit të vendit”, është theksuar në reagimin e PDK-së. Edhe deputetja Blerta Deliu ka reaguar pas largimit të fotografisë së presidentit Hashim Thaçi nga zyra e



kryetare së Kuvendit. Deliu në një postim në rrjetin social “Facebook” ka shkruar se fotografia zyrtare e presidentit, të cilën obligohen ta vendosin të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës në mjediset e tyre bazuar në Ligjin për Protokollin e Shtetit, të martën u hoq nga kryeparlamentarja e re, Vjosa Osmani, e cila qysh në ditën e

parë të punës bëri shkelje ligjore. “Fotografia zyrtare e presidentit, të cilën obligohen ta vendosin të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës në mjediset e tyre bazuar në Ligjin për Protokollin e Shtetit, sot u hoq nga kryeparlamentarja e re, Vjosa Osmani, e cila qysh në ditën e parë të punës bëri shkelje ligjore. Mandati i saj është udhëheqja e

organit që nxjerr dhe miraton të gjitha ligjet por, siç edhe dëshmoi, vetë ajo është selektive në zbatimin e legjislacionit të Kosovës. Ky është një standard i ri për institucionet e Kosovës dhe një lojë tërësisht fëmijërore që nxjerr në pah më së shumti papjekurinë politike dhe teket personale të Vjosa Osmanit”, ka shkruar Deliu.

## Osmani në takim me Kosnettin: Partneriteti me ShBA-më është ekzistencial për Kosovën

**PRISHTINË, 4 SHKURT (ER)** - Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në takimin e parë zyrtar ka takuar ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip S. Kosnett. Ambasadori Kosnett e ka uruar kryetaren Osmani për detyrën e re, duke ofruar përkrahje dhe bashkëpunim.



Në takim me ambasadorin amerikan kryetarja Osmani ka diskutuar për prioritetet e Kuvendit, rritjen e efikasitetit dhe mbikëqyrjes së Kuvendit në raport me qeverinë, avancimin e diplomacisë parlamentare, bashkëpunimin me opozitën si dhe me të gjithë aktorët e tjerë relevantë.

Kryetarja Osmani e vlerësoi ekzistencial bashkëpunimin dhe partneritetin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke u zotuar që ky bashkëpunim të thellohet edhe më tej në të ardhmen. “Miqësia dhe partneriteti me ShBA-në janë ekzistenciale për Kosovën”, ka thënë Osmani.

# Përgjegjësia sociale korporative, e rëndësishme për qëndrueshmërinë e bizneseve

PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Përveç përfitimeve që përgjegjësia sociale korporative sjell në mirëqenien e shoqërisë, ajo ka një impakt të madh në qëndrueshmërinë e bizneseve, me theks të veçantë në krijimin e një imazhi më të mirë për ata që janë aktivë në këtë aspekt. Kjo u konkludua gjatë një tryeze të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, ku përfaqësuesit e kompanive anëtare patën mundësinë të diskutojnë mbi efektin e aktiviteteve të tyre në të mirë të shoqërisë.

Agim Hasani nga NLB Bank theksoi se edhe pse institucioni të cilin ai e përfaqëson ka karakter komercial, përgjegjësia

sociale korporative për ta ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Sipas tij, fokus i veçantë i kësaj kompanie është kujdesi ndaj segmenteve të caktuara të shoqërisë, të cilat në njëfarë forme janë të marginalizuara, duke shtuar se vitet e fundit NLB Banka është jashtëzakonisht aktive me projekte të ndryshme të kësaj natyre.

Hasani tha se aspektet e CSR janë të kushtëzuara edhe nga sukseset e institucionit, ku të njëjtat paraqesin një motiv shtesë për rritjen e angazhimeve në drejtim të përgjegjësisë sociale korporative.

Nora Tuli-Karahoda nga

Cactus u shpreh se kjo kompani ka mbështetur shumë kauza sociale, gjersa edhe me iniciativë individuale ka treguar përgjegjësi ndaj shoqërisë. Ajo tha se, përveç në mënyrë filantropike dhe në vetëdijesim të komunitetit të biznesit për pjesëmarrje në aktivitete të ngjashme, veprimtaria e Cactus ka ndikuar edhe në krijimin e një atmosfere më të mirë brenda organizatës, duke e transmetuar një ndjenjë për të qenë aktivë përveç te stafi, edhe te studentët e Cactus Education.

Erina Rrahmani, udhëheqëse e projektit në Fondacionin "Jahjaga", shtoi se një ndër efektet pozitive të përfshirjes së

bizneseve në kauza sociale është edhe krijimi i konsumatorëve besnikë. Sipas saj, politikat e CSR brenda një kompanie e rrisin vlerën e perceptuar të konsumatorëve ndaj kompanisë, e bashkë me këtë sjellin besnikëri sidomos nga ata klientë që besojnë në vlera të njëjta. Tutje, ajo u fokusua në nevojën e përfshirjes së grave në pozita udhëheqëse dhe nevojën për diversitet në institucione.

Anita Kosumi nga Banka për Biznes tha se edhe për këtë kompani është shumë me rëndësi pjesëmarrja në aktivitete të lidhura me CSR. Me shpalosjen e disa prej projekteve të BPB-së, Kosumi

tregoi për mbështetjen që kjo kompani e ka dhënë sidomos në fushën e kulturës dhe sportit, gjithashtu në rritjen e profesionalizmit të rinjtë. Ajo e konsideroi shumë të rëndësishme përfshirjen e çdo kompanie në aktivitete të tilla, sidomos për shkak se ato e rrisin moralin jo vetëm brenda kompanisë, por edhe më gjerë. Gjatë kësaj tryeze u diskutua edhe mbi nevojën për më shumë investim në edukim, pavarësisht se kthimi në këtë investim bëhet në terma më të largëta kohore. Të pranishmit shtuan se është shumë me rëndësi që promovimi i aktiviteteve të CSR të bëhet pa pagesë.



## Çfarë do të ndodhte në Shqipëri nëse çmimi i duhanit do të rritej me 25 për qind?

TIRANË, 4 SHKURT - Sipas një studimi global, pjesë e të cilit është edhe Shqipëria, një rritje e taksimit të duhanit do ta ulte konsumin e tij dhe paralelisht do t'i rriste të ardhurat për arkën e shtetit shqiptar. Kjo është një nga gjetjet kryesore të studimit "Më të shëndetshëm dhe më të pasur - përse taksimi i duhanit është i nevojshëm jo vetëm për shëndetin, por edhe për ekonominë", të prezantuar nga qendra 'Development Solutions Associates' (DSA).

Një nga vendet me normat më të larta të duhanpirjes në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë, ku thuajse një në çdo dy meshkuj konsumon duhan, Shqipëria po përjeton disa reforma të rëndësishme mbi rregullimin e mëtejshëm të duhanit, në mbrojtje të shëndetit publik. Në këtë kontekst, ky studim ofron disa



gjetje dhe perspektiva me vlerë të shtuar për publikun dhe institucionet shqiptare të shëndetit publik si pjesë e projektit shkencor ndërkombëtar "Përsheptimi i Progresit mbi Politikën e Efektshme të Taksimit të Duhanit në Vendet me të Ardhura të Ulëta dhe të Mesme". "Sipas studimit,

rezulton se Shqipëria ka barrën më të ulët tatimore mbi duhanin në Ballkanin Perëndimor, duke e renditur ndër vendet e pakta që aplikojnë vetëm akcizë specifike ndaj duhanit. Kjo barrë tatimore llogaritet në masën 35.8 për qind për vitin 2018 dhe me vetëm një rritje modeste për vitin 2019. Gjithashtu, të

ardhurat nga duhani llogariten në 5.15 për qind të të ardhurave totale nga taksat, apo në rreth 1.32 për qind të PBB-së së vendit. Ndër gjetjet e tjera të studimit është që rritja e çmimit të cigareve, e shkaktuar nga rritja e taksimit, ka rezultuar në ulje të konsumit të duhanit. Por nëse do të kishte rritje të çmimit të shitjes me 25 për qind, si pasojë e rritjes së taksimit, do të kishte një rënie të konsumit të duhanit prej më shumë se 17 për qind, krahas një mbledhje më të lartë të taksave në nivelin 15 për qind, apo mbi 36 milionë euro më shumë", thuhet në njoftimin për media nga DSA, raporton "Scan tv".

Sipas gjetjeve të studimit, kjo rritje e taksimit dhe, rrjedhimisht, e çmimit, do të ndikonte më shumë në uljen e konsumit të konsumatorët me të ardhura të ulëta, të cilët do të

prireshin të konsumonin më pak duhan. "Ky përfundim është i rëndësishëm sepse janë më të varfrit ata që cenohen më shumë nga problemet që lidhen me duhanin, përfshirë ato shëndetësore, por edhe ekonomike", ka theksuar dr. Edvin Zhllima, një ndër autorët e studimit.

Aktualisht kostot nga konsumi i duhanit ndaj ekonomisë shqiptare, përfshirë kostot e drejtpërdrejta shëndetësore dhe ato të tërthorta nga rënia e produktivitetit si pasojë e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, llogariten në rreth 270 milionë euro.

Ky studim është kryer nga DSA në bashkëpunim me Universitetin e Ilinoisit në Chicago dhe disa institucione të tjera në Ballkanin Perëndimor, me mbështetjen e Bloomberg Philanthropies.



# Odat ekonomike, qeverisë së re: Të ketë lëvizje përpara në agjendën e reformës së biznesit

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) dhe Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) kanë mirëpritur formimin e Qeverisë së re të Kosovës, në një kohë kur, sipas këtyre odave ekonomike, vendi ka nevojë që të lëvizë përpara në agjendën e reformës së biznesit

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 SHKURT - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) dhe Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) kanë mirëpritur finalizimin e konstituimit të institucioneve të dala si rezultat i zgjedhjeve të 6 tetorit 2019. Gjithashtu, kanë kërkuar që të ketë lëvizje përpara në agjendën e reformës së biznesit.

“Institucionet funksionale ekzekutive e legjislative janë kyçe në ofrimin e një qeverisje të mirëfilltë ekonomike. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë mirëpret konstituimin e Qeverisë së re të Kosovës në një kohë kur vendi ka nevojë që të lëvizë përpara në agjendën e reformës së biznesit”, është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane.

Oda Ekonomike Amerikane ka theksuar se beson se adresimi i çështjeve që lidhen me kapitalin njerëzor, përmirësimi i sundimit të ligjit, zbatimi i drejtë i ligjeve, si dhe luftimi i korrupsionit duhet të jenë në themel të agjendës së qeverisë së re, ndërsa hartimi i një strategjie të fuqishme kombëtare të zhvillimit ekonomik duhet të

jetë ndër prioritetet më të rëndësishme të organit të ri ekzekutiv.

“Institucionet funksionale ekzekutive e legjislative janë kyçe në ofrimin e një qeverisje të mirëfilltë ekonomike. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë mirëpret konstituimin e Qeverisë së re të Kosovës në një kohë kur vendi ka nevojë që të lëvizë përpara në agjendën e reformës së biznesit”, është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane.

Sipas kësaj ode, qeveria e re duhet të garantojë një ekonomi të lirë të tregut si dhe një mjedis të barabartë i cili do t'i lejonte investitorët vendorë dhe të huajë ta shfrytëzonin potencialin e tyre të plotë për një rritje të përsheptuar ekonomike, e cila do të ndihmonte në krijimin e vendeve të reja të punës, ngritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe, rrjedhimisht, ofrimin e perspektivës më të madhe për të gjithë.

“Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë thërret qeverinë e re të demonstrojë rol aktiv në fuqizimin e dialogut me sektorin privat, meqë vetëm përmes një ndërveprimi të vazhdueshëm dhe të hapur Kosova mund t'i përmbushë



synimet e saj të zhvillimit ekonomik”, është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane.

Edhe Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka mirëpritur formimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet 6 tetorit. “Komuniteti i biznesit, përkatësisht 16 000 ndërmarrje të përfaqësuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, e mirëpresin krijimin dhe fillimin e punës të kabinetit të ri qeveritar, të udhëhequr nga kryeministri

Albin Kurti, si një hap tjetër i rëndësishëm i konsolidimit të demokracisë në vend dhe parakusht themelor për vazhdimin e reformave që mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik”, është thënë në komunikatën e OEK-ut, duke u shtuar se Oda Ekonomike e Kosovës kërkon nga qeveria e re që ta kompensojë kohën e humbur nga periudha parazgjedhore dhe paszgjedhore, me një dinamikë të shtuar në

reformat prioritare ekonomike që synim kryesor duhet ta kenë rritjen e sektorit privat në Kosovë, bazuar në parime të qarta të ekonomisë së tregut. “Oda Ekonomike e Kosovës do të jetë partnere serioze dhe profesionale në adresimin e të gjitha temave dhe çështjeve që kanë ndikim në rritjen e sektorit privat në vend dhe njëherë ofron ekspertizën profesionale në adresimin e tyre”, thuhet në komunikatën e OEK-ut.

## Koronavirusi godet naftën, humbje të mëdha për arin e zi

PRISHTINË, 4 SHKURT - Prodhuesit më të mëdhenj të naftës në botë duhet të përgatiten ta zvogëlojnë prodhimin për shkak të koronavirusit që nuk po arrihet të frenohet.

Përfaqësuesit e OPEC-së dhe aleatët e tyre pritet të takohen këtë javë teksa shtohen thirrjet për veprim në mbështetje të çmimit të naftës. Nafta e përpunuar Brent mbërriti nivelin më të ulët të kuotimit pasi ra 20 për qind nga maja ku u vendos në muajin shtator. Po përse epidemia ka një ndikim kaq të madh në tregun global të energjisë? Koronavirusi i ri u shfaq në kohën kur Kina përgatitej ta kremtonte Vitin e ri Hënor. Pushimet e festave u zgjatën, në pjesën më të madhe të vendit janë vendosur kufizime të

rrepta të udhëtimit dhe zyrat e dyqanet mbeten të mbyllura. Kjo do të thotë, importuesi kryesor i naftës bruto në botë, që konsumon zakonisht rreth 14 milionë fuçi në ditë, ka pasur më pak nevojë për naftë që të vinte në punë makineritë, automjetet e t'i mbante dritat ndezur.

Shpërthimi epidemik nga ana tjetër pritet të ketë ndikim të madh edhe te kërkesa për karburant të avionëve, sepse linja ajrore në mbarë globin i ka pezulluar fluturimet me Kinën. Edhe kufizimet brenda vendit gjithashtu nënkuptojnë reduktim të numrit të fluturimeve.

Shkalla e rënies ka tronditur industrinë e energjisë, sipas analistit të naftës me bazë në Çikago, Phil Flynn. “Ne nuk kemi parë një event shkatërrues të



kërkesës në këtë nivel dhe që lëviz kaq shpejt”, është shprehur ai. Bloomberg raportoi këtë javë se

konsumi ditor i naftës së papërpunuar në Kinë ka rënë me 20 për qind, ekuivalenti i nevojave

për naftë të Mbretërisë së Bashkuar dhe Italisë, të marra së bashku. (tch)

# ZARET U HODHËN, A PO KALOHET RUBIKONI PËR TË SHPËTUAR APO PËR T'U FUNDOSUR?!



Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

## Pas betejës të gjithë analistët (gjenralët) bëhen të mençur:

Ishte një gjendje e rëndë, nga 6 tetori 2019, kur përfunduan zgjedhjet e deri më 2 shkurt 2020, kur u nënshkrua marrëveshja për bashkëqeverisje midis LV-së, që i fitoi zgjedhjet dhe LDK-së, që doli e dyta. Ky ishte vullneti i votuesve dhe mbështetur në këtë vullnet u bë edhe koalicioni. Dua ta them se më shumë kohë, nerva, durim, vuajtje, lodhje dhe stres kanë shkaktuar bisedimet bilaterale Kurti - Mustafa, të cilët mund të vendosin vetëm për zgjidhjen e një numri të vogël të problemeve në Kosovë, se takimi i famshëm Stalin - Çerçill dhe Ruzvelt në Jaltë dhe Teheran që vendosi për fatin e shumë shteteve dhe popujve të botës. Nëse i krahasojmë këto dy marrëveshje në kontekstin gjeostrategjik atëherë duhet të pranojmë se Traktati Kurti - Mustafa është shumë më i rëndësishëm, së paku për qytetarët e Kosovës dhe Natalya Apostolova, e cila, së bashku me Mogerinin aq shumë u angazhua që qytetarët e Kosovës ta fitojnë liberalizimin e vizave, se marrëveshja e Jaltës dhe Teheranit. Gjatë bisedave maratonike Kurti - Mustafa huqjen më të madhe e patën analistët, thuaja 2.000.000 analistë (shkaku se çdo qytetar i Kosovës është analist) sepse në shumicën e falleve e gabuan fort hajmalinë që duhej të përdoret. Edhe analistët sikur edhe mediet ishin qartë të ndarë në dy grupe, ata që ishin për marrëveshjen Kurti - Mustafa dhe ata që ishin kundër. Fitohet përshtypja se edhe paguheshin për këtë! Që nga 6 tetori 2019 në të

gjitha shkrimet dhe prononcimet kam thënë se nuk do të ketë koalicion tjetër përveç LV-së me LDK-në dhe këtë nuk e kam bërë këtë se jam fort i mençur, por kam qenë i sigurt se edhe LV-ja sikur edhe LDK-ja po luajnë me karta bllof për faktin se as LV-ja e as LDK-ja nuk kanë qenë të vendosura të shkojnë në zgjedhje të reja e as të kalojnë në opozitë. LV-ja e ka pasur gjakim udhëheqjen e qeverisë, me Albin Kurtin kryeministër dhe, nëse kësaj radhe Albin Kurti do ta lëshonte zogun nga duart, atëherë e tërë karriera e tij do të kalonte duke dëgjuar cicërimën e zogjve në pullaze apo degë të pemëve. LDK-ja që nga viti 2004 asnjëherë nuk ka fituar zgjedhjet, por asnjëherë nuk ka mbetur pa pushtet prandaj, në një mënyrë apo tjetër ka krijuar vartësi ndaj pushtetit. Dhe këtu nuk shoh asgjë të keqe sepse në politikën tonë, pa standarde morale dhe profesionale, ikja nga pushteti llogaritet si çmenduri. LDK-ja e ka luajtur lojën mirë, gjatë tërë kohës sa nuk i fitonte zgjedhjet duke fituar më shumë se vetë partia që i ka fituar zgjedhjet! LDK-ja sot akuzohet se ka bërë marrëveshje joparimore dhe jo të natyrshme me LV-në, por a nuk ishte e tillë edhe marrëveshja PDK-LDK. Në këtë rrafsh nuk shoh asnjë dallim! Për çdonjërin që ka informata elementare e që nuk është dashur ndonjë inteligjencë mbi mesataren kosovare për vlerësim të situatës, ka qenë e qartë se votuesi brenda Kosovës e sidomos votuesi që e ka votën përcaktuese për çdo gjë në Kosovë (faktori ndërkombëtar që vranë e nuk kthjellë së paku deri më tani) kanë qenë për pozitën që u votua dje, kurse shprehimisht dhe vendosmërisht ka qenë kundër pozitës së deridjeshme dhe opozitës së sotme. Për këtë ua ka lëshuar në qafë prokurorët e Hagës, të UNMIK-ut, EULESH-it dhe përsëri të Hagës, jo për t'i dënuar për korrupsion, por për krime

luftë, në ndërkohë që me Vuçiqin, Dikoviçin, Gurin, Sheshelin, Vulinin dhe Daçiqin kanë ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi dhe miqësore. Ndoshta në lokacionin ku takohen dhe i cakërojnë gotat me shlivovicë, përfundi këmbëve të tyre mund të jenë të varrosura mbetjet mortore të shqiptarëve të ekzekutuar, për fatin e të cilëve janë në ankth 21-vjeçar, kryesisht familjarët e tyre. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nga ndërkombëtarët në Kosovë ka qenë një veprim në kundërshtim të plotë me veprimet që i kanë ndërmarrë në shtetet, shtetas të të cilëve edhe janë. Në Kosovë janë treguar të paskrupullt, të pamoralshëm dhe vetë janë bërë pjesë e skemave piramidale kriminale, që nga ambasadorët, prokurorë dhe gjykatës dhe nivele më të ulëta. Për ndërkombëtarët aspak nuk ka qenë me rëndësi a jeni të vullnetshëm ta luftoni korrupsionin dhe krimin e organizuar sa që të jeni të vullnetshëm të bëni bisedime me Serbinë, të gjeni zgjidhje kreative duke treguar fleksibilitet, në dëm të Kosovës, pa asnjë dyshim! Se a do të ndryshojë kjo qasje me qeverinë e re të vjetër nuk mund ta paragjykoj. Mirëpo, është shumë e qartë se kërkesa imediate e bashkësisë ndërkombëtare nuk është lufta kundër korrupsionit, por heqja e taksës 100 për qind për mallrat serbe sikur edhe vazhdimi i bisedimeve me Serbinë që, për momentin, nuk janë domosdoshmëri për Kosovën. Taksë 100 për qind për mallrat serbe ka qenë potezi më i mirë, më i shëndetshëm, më i dinjitetshëm në aspektin kombëtar dhe shtetëror dhe më frenuesi ndaj aktiviteteve 100 për qind armiqësore të Serbisë ndaj Kosovës. Të kërkojë një baraspeshim midis taksës 100 për qind dhe ndaljes së fushatës së çnjohjeve që po e bën Serbia është një imoralitet i skajshëm dhe prostituim i konventave

ndërkombëtare. Ramush Haradinaj, nëse asgjë të mirë nuk ka bërë gjatë mandatit dyvjeçar, taksa 100 për qind për mallrat serbe është mbulesë e mjaftueshme sepse e ktheu dinjitetin kombëtar dhe shtetëror! Na bëri të ndihemi shtet!

**Qeveria Kurti dhe qeveria Murti:** Pa praninë e opozitës, përjashtuar këtu opozitarin më konsekuent dhe më pozitiv, Behgjet Pacolli, vetë i dyti që votuan për qeverinë Kurti, opozitarët e tjerë e lëshuan sallën kur u votua qeveria. Isha në sallë dhe kur kryesuesja e seancës, zonja Arbërie Nagavci, e cila ka bërë një përparim të jashtëzakonshëm krahasuar me kohën kur vendosi të merrej me politikë, tash ka një siguri më të madhe oratorike dhe po lexon shumë mirë, tha se u votua qeveria Kurti me 86 vota dhe shifra më dukej shumë imagjinare, e pabesueshme dhe e pavërtetë. Doli pastaj që qeveria Kurti mori 66 vota (59 vota shqiptare nëse të Pacollit llogariten si të tilla) dhe 7 minoritare. Pa 2 vota të Pacollit dhe 2 vota të Dudes e që vendosën të votojnë në momentin e fundit, qeveria do t'i kishte 62 vota, do të ishte Qeveri e Pakicës. Lista Serbe nuk e votoi qeverinë Kurti duke deklaruar se ata i besojnë Marko Gjuriqit e jo Albin Kurtit, në ndërkohë që po kjo Listë Serbe 100 për qind i shërben Serbisë, 100 për qind është kundër Kosovës dhe 100 për qind i shfrytëzon të mirat që ia ofron buxheti i Kosovës. Asnjë vend normal nuk do ta duronte këtë por, pasi e duruan më parë PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, pse mos ta durojë tani edhe LV-në! Jemi një sa i përket Listës Serbe, shumë e kritikojmë, por edhe më shumë i vardisemi kur kemi nevojë për votat e tyre. Mos të harroj, një lider, serb i Kosovës, z. Petroviq, pasi u takua me kryeministrin Kurti dhe pasi nuk u mor në mbrojtje nga askush nga terrorizimi që ia bënte Lista Serbe dhe Serbia, dha dorëheqje dhe duket se këtë

fat do ta kenë edhe serbët e tjerë që e pranuan Kosovën dhe u shërbyen të gjithë qytetarëve të Kosovës. E kam fjalën për Sllobodan Petroviqin dhe Nenad Rashiqin. Këta ishin liderët serbë me të cilët Kurti donte të bënte dialog, si përfaqësues të serbëve të Kosovës! Më të fortë dolën të jenë Goran Rakiq dhe Marko Gjuriq. Po cila është qeveria Kurti?

LV-ja, përkatësisht kryeministri Kurti, emrat e ministrave të LV-së i bëri publik kohë më parë përmes një video-mesazhi. Aty mungonte vetëm emri i Glauk Konjufcës që u zgjodh kryetar i Kuvendit të Kosovës. Pastaj, Glauk Konjufca u bë pjesë e kabinetit qeveritar.

## Qeveria Kurti

1. **Albin Kurti është kryeministër i Kosovës.** Është shembull tipik se nëse ia vëni vetes një qëllim, jeni këmbëngulës dhe të vendosur, sigurisht se do t'ia arrini këtij qëllimi. Rruga e Albin Kurtit nuk ka qenë e shtruar me lule, por me shumë vuajtje dhe sakrificë. Ishte një ndër liderët e rezistencës studentore që u keqtrajtua brutalisht nga policia serbe. Në moshë të re, kur shumica iknin nga Zyra e UÇK-së në Prishtinë e që udhëhiqej nga Kuptimi dhe Përmbytja e Luftës për Çlirim, Liri dhe Bashkim Kombëtar, Bacë Adem Demaçi, Albin Kurti, përkundër rrezikut edhe për jetë, u bë sekretar, përkthyes, këshilltar dhe shoqëruar i Bacës, deri në kohën kur u bë lider i opozitës dhe deputet i Kuvendit të Kosovës. Albin Kurti sot nuk e përmend fare Adem Demaçin ose e përmend gjatë përvjetorit të shkuarjes në amshim. Albin Kurti ishte kundërshtar i UNMIK-ut, EULEX-it sepse mendonte se po punojnë kundër Kosovës. Për atë kohë Albini bëri opozitë të arsyeshme, të dobishme dhe të domosdoshme, jo pse pengoi realizimin e marrëveshjeve të dëmshme për Kosovën, por se e

ngadalësoi implementimin e tyre. U arrestua dhe u rrah nga të gjithë, por nuk u tregua aspak i mëshirshëm ndaj të gjithëve që i projektonte jo si kundërshtar politikë, por armiq politikë. Albin Kurti mban mend, por nuk fal; nëse ju ka futur në listën e armiqve, përherë do të jeni në atë listë. Po e kundërshtuat edhe kur keni të drejtë, nuk do të keni të drejtë. Ata që më së shumti e kanë përkrahur kur e ka pasur ngushtë, jo që nuk i ka vlerësuar, por i ka sulmuar! Tash e kemi një Albin tjetër që duket i reformuar dhe është shumë mirë nëse vërtet u bë i tillë. Koha dhe ngjarjet domosdoshmërisht ju ndryshojnë, nëse doni t'i mbijetoni kohës dhe të jeni në krye të ngjarjeve. Ishte biblike durimi që Albini e manifestoi dje para votimit të qeverisë Kurti. Opozita ishte e pamëshirshme, por e luftoi Albinin, me armët e vet Albinin. Albini u tregua i mençur dhe i mençur është. Pushteti, përveç se ju bënë më të kujdesshëm, ju vesh edhe me mençuri. Deri më sot jam i sigurt se Albini si Albin është i pakorruptueshëm, por jo edhe disa rreth tij, është trim dhe kombëtarisht është i paluhatshëm. Besoj se Albini në asnjë rrethanë nuk do ta dëmtojë interesin kombëtar dhe shtetëror. Lakmia për pushtet është e natyrshme. Millovan Gjillas, një ish-udhëheqës komunist jugosllav, pati deklaruar se "pushteti është pasioni më i madh...". Topi nuk e luan. Albini do të bënte kthesa të mëdha po të mos ishin bisedimet me Serbinë. Ato, ose do ta bëjnë një Hasan Prishtinë (i kërkoj falje Agim Bahtirit të cilin Albini e ka shpallur Hasan Prishtinë), ose do ta shtrijnë për toke! Të mesme nuk ka!

**2. Avdullah Hoti, zëvendëskryeministër i parë:** Është në politikë dhe në LDK që nga koha e Skënderbeut e këndeje. Është një teknokrat tipik dhe, në çaste të caktuara e përdorë një fjalor kërcënues që nuk i shkon me përmbajtjen e brishtë prej intelektualit dhe profesori që e ka. Nuk e di rolin që do ta ketë në qeverinë Kurti.

**3. Haki Abazi, zëvendëskryeministër i dytë:** Është fatosi më i ri i LV-së, i ri fare, thuaja i porsalindur në LV, foshnje katërmuajshe (aq kohë ka që është vendosur - anëtarësuar në inkubatorin e LV-së). E kam pasur një shkrim për të, por nuk do ta botoj pa u bërë, së paku, 100 ditë të qeverisjes.

**4. Glauk Konjufca, ministër për Punë të Jashtme dhe Diasporë:** Pasi e luajti lojën me Albinin për kryetar të Kuvendit, po bëhet trashëgimtar i denjë i një ministri të jashtëzakonshëm, Behgjet Pacolli që, këtë

ministri e bëri shtëpi publike, ku prostitucioni politik ishte referencë për karrierë. Një trashëgimi të ngjashme i ka lënë edhe ish-ministri i Diasporës. Fizikisht ka përparësi mbi Daçiqin. Glauku do të jetë krah i Albinin për bisedime me Serbinë ku do ta kenë përgjegjësinë direkte, kurse partnerja qeverisëse, LDK-ja, nga bregu do ta përcjellë ekzekutimin politik që do t'ua bëjnë ndërkombehtarët, nëse dalin jashtë planeve të tyre.

**5. Blerim Reka, ministër i Integritetit Evropian:** Ministri së koti, ministri ku bëni shtatë palë qejfe. Ministri që ua fyen inteligjencën për faktin se Evropa na ka izoluar dhe na trajton si dhe na ka futur në karantenë si ta kishim korona virusin, ndërsa ne e luajmë rolin e mizës së kalit duke iu futur në prapanicë. Për Blerim Rekën është sikur t'i caktoni një vend të punës në shtëpi, Brukselin edhe si diplomat i Maqedonisë së Veriut e ka pasur shtëpi të dytë!

**6. Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë:** Mund të ketë rezultate vetëm nëse i kontrollon emocionet dhe nëse prangat apo kllapat për burgosje ia dorëzon Policisë së Kosovës. Duhet ta ketë të qartë se vetingu nuk bëhet nëse e largoni një prokuror apo gjykatës në të cilin eventualisht keni marrë në thua dhe ta zëvendësoni me një analfabet që ju pëlqen apo ju dëgjon. Le ta merr shembull vetingun në Shqipëri ku detyrohen të largohen prokurorë dhe gjykatës shumë profesionistë, por të korruptuar, kurse në vend të tyre emërohen prokurorë dhe gjykatës edhe më shumë profesionistë, por të pakorruptuar. A e kemi të njëjtën gjendje në Kosovë?

**7. Besnik Bislimi, ministër i Financave dhe Transfereve:** Ka qenë dorë e djathë e Albinin në bisedimet e Jaltës me Isa Mustafën. Thonë se është ekspert i fushës. Kam dëgjuar për ministër të Financave, por jo edhe të Transfereve. Kam menduar se transferet bëhen vetëm në futboll dhe sporte të tjera. A nënkupton se Besnik Bislimi do ta transferojë Lionel Mesin nga Barcelona në Inter? Ta shohim!

**8. Rozeta Hajdari, ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike:** Shumë detyrime për një person. Ministri shumë ambicioze edhe për një ministër të shokut Enver. Nuk e njoh fare zonjën në fjalë, kur e pashë mendova se është shoqëruese e Blerim Rekës.

**9. Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë:** E njoh si punëtor të madh, të pakorruptueshëm dhe çun për

së mbari. Po vjen në kohë të keqe në këtë pozitë, në kohën e koronavirusit. Sidomos të atij politik.

**10. Hykmete Bajrami, ministre e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit:** Zoti i ndihmoftë të bëjë pakëz dritë në tempullin e errësirës! Mbi kokë do t'i rrijë dështimi i Projektit të Brezovicës gjatë mandatit të saj. Është veterane dhe militante e LDK-së. Do ta udhëheqë Ministrinë më të ndjeshme dhe më të rëndësishme. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, hoxhallarët i mësonin shkrimlexim analfabetët. A do të arrijë edhe Hykmete Bajrami ta bëjë analfabetizmin të durueshëm dhe të pranueshëm?

**11. Vlora Dumoshi, ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:** E ka më së lehti; jemi popull shumë i kulturuar, sportin (shtyrjen me bërryla) e kemi sport kombëtar, kurse afërsisht 60 për qind janë të rinj. Edhe qeverinë e kemi të re fare!

**12. Anton Çuni, ministër i Mbrojtjes:** E ka shumë lehtë. I ka 10 000 ushtarë aktivë dhe rezervë si dhe 100 000 veteranë të luftës. Populli i armatosur, atdheu i sigurt! Mbështetur nga mbiemri, del të jetë Çun. Mbështetur nga e kaluar, del të jetë veteran. Uroj të jetë më i ngadalshëm në ngrehjen e këmbëzës së armës sesa fjalës së folur.

**13. Lumir Abdixhiku, ministër i Infrastrukturës dhe Ambientit:** Ministri problematike për faktin se në Kosovë mungon Infrastruktura për Ambient. Si kuadër i RIINVEST-it e gjen formulën hokus-pokus apo si Magjistari i Ozit. Në rrethanat aktuale as Hudini nuk do të gjente zgjidhje për ambient kur ky është shndërruar në biznes.

**14. Besian Mustafa, ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural:** Kam menduar se Besiani i takon gerilës urbane, po del të jetë ndryshe.

**15. Agim Veliu, ministër i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike:** Më thirri një mik dhe më tha se ju llapjanët e morët SUP-in (Sekretariajat Unutrashnjih Poslova - Sekretarijati i Punëve të Brendshme në ish-Jugosllavi). Unë gjërat i shoh ndryshe; nuk është aspak e rastit që njeriu më i fortë i LDK-së u bë ministër i këtij resori. Isa Mustafa, Agim Veliu dhe Luta e shpëtuan LDK-në edhe nga ndarja, edhe në bisedimet bilaterale Kurti - Mustafa. Po të mos ishin këta të tre, Vjosa Osmani nuk do të ulej në karrigen e kryetares së Kuvendit. Kaq për tani, më vonë mund të elaboroj pse Agimi u bë ministër i Brendshëm.

**16. Emilija Rexhepi, ministre e**

**Administrimit të Pushtetit Lokal:** U bë ministre me këmbëngulësi. Gjysmën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës i var për beli dhe bën hiking maleve të Sharrit, pa asnjë problem.

**17. Dalibor Jeftiq, ministër i Aleksandar Vuçiqit dhe Ivica Daçiqit në Qeverinë e Kosovës,** i maskuar si ministër për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës dhe

**18. Ivan Mihajloviq, ministër për Zhvillim Rajonal të Serbisë,** ministër i Vuçiqit dhe Daçiqit në Qeverinë e Kosovës.

**Çka tash:** Besoj se dy muaj do të shkojnë për përhëndetje dhe urime, vizita të diplomatëve të huaj dhe të tjera. Matjet e para të performancës bëhen pas 100 ditë të punës dhe qeveria duhet të përkrahet. Pastaj, shohim e bëjmë.

**Opozita e pozitës:** Opozita dje ishte e pamëshirshme ndaj Albin Kurtit, i përdori armët e Albinin dhe modelin e Albinin. Opozita është shumë e fuqishme, mund ta ndihmojë shumë Kosovën nëse e luan një rol konstruktiv, kurse mund të jetë shumë destruktive sepse ka potencial të madh destabilizues. Uroj që opozita të jetë konstruktive, të jetë bashkëpunuese. Realisht, jetëgjatësia e pozitës dhe puna e saj më shumë do të varet nga opozita se nga 66 vota që i fituan si votëbesim. Çdo veprim që pozita do ta ndërmerret ndaj opozitës duhet të peshohet mirë. Albin Kurti, si kryeministër i të gjithëve, vazhdimisht duhet të dërgojë mesazhe bashkëpunimi opozitës dhe nëse opozita e refuzon bashkëpunimin, përgjegjësia i adresohet opozitës. Opozita nuk mund të frikësohet me kërcënime për arrestime. Opozita ka treguar kulturë demokratike pas zgjedhjeve duke pranuar rezultatin e zgjedhjeve, standard i munguar deri më tani. Kosova është në udhëkryq; a do ta bartin modelin e të bërit opozitë sikur në Shqipëri apo do të vazhdojnë me standardin e vendosur pas përfundimit të zgjedhjeve?! Edhe unë jam për moton: "Hajnat në burg...", edhe të LV-së, edhe të LDK-së, edhe të AAK-së, edhe të PDK-së, edhe të Nismës si dhe hajnat e shoqërisë civile që i mbulojnë hajnitë e tyre duke sulmuar të tjerët, politikanët në radhë të parë! Euforia kalon shpejt, problemet do të jenë të njëjta. Trysnia e faktorit ndërkombehtar për të bërë lëshime politike vetëm sa do të rritet. Për fillim heqja e taksës 100 për qind.

**Vjosa Osmani:** Pa problem dhe me sukses do ta udhëheqë Kuvendin e Kosovës. Ka përvojë si deputete dhe e ka aktivitet të fushës profesionale. Shpresoj

se edhe kryetarja e Kuvendit duhet ta respektojë ligjin dhe ligjet. Nuk ka të drejtë ligjore ta heqë foton e presidentit aktual, Hashim Thaçi. Deri në zgjedhjen e presidentit të radhës! Nuk është Vjosa Osmani kryetare e Kuvendit të LDK-së, por kryetare e Kuvendit të Kosovës! Falë luftës së të lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës, pjesë e së cilës ka qenë edhe Hashim Thaçi dhe këta që i quan kriminelë, Vjosa Osmani është sot kryetare e Kuvendit të Kosovës. Si e re dhe intelektuale, duhet të tregojë tolerancë maksimale dhe t'i respektojë vuajtjet dhe sakrificat që u bënë gjatë këtyre 100 vjetëve e sidomos, që ajo mban mend, para, gjatë dhe pas përfundimit të luftës çlirimtare! Në të kundërtën do të rishkruhet Ferri i Dante Aligerit në Kosovë ku askush nuk do të fitojë dhe të gjithë do të jenë humbës. Këta që po bëjnë përpjekje të shkelin mbi sakrificat duhet ta kenë të qartë se në kohën kur një pjesë e kabinetit qeveritar ka kënduar: "Druzhe Tito mi ti se kunemo da sa tvoga puta ne skrenemom=Shoku Tito ne të betohemi, se nga rruga jote nuk do të largohemi..." shumë prej nesh kanë dhjerë në kanta të ndryshkura të metalit dhe kanë pshurrur gjak, jo nga sëmundja, por nga disa prej paraardhësve tuaj. Ne kemi treguar durim, kemi falur edhe çka nuk falet, ndërkaq që e merrni si dorëzim dhe ligësi. Kush mendon ashtu, gabon shumë rëndë! Mos na provoni sepse sakrificat që e kemi bërë është pakrahasimisht më e madhe se e disa paraardhësve tuaj. Kujtojeni Adem Demaçin, 30 vjet jete në llogoret e ish-Jugosllavisë. Ai është frymëzim, është shpresë dhe kushtrim për liri! Mos na provokoni se çdo i dënuar politik shqiptar e ka një aktgjykim ku janë hetuesit, prokurorët dhe ata që na dënuan, ata që na torturuan, na vranë dhe na sakatosën. Shumë janë shqiptarë dhe do të ndiheni keq pastaj. A doni t'i bëjmë këto të dhëna publike për ta lënë pastaj Albulena Haxhiu pa mundësi të bëjë vetingun. Vetingu i mirëfilltë është në aktgjykimet e të burgosurve politikë, në varret e të ekzekutuarve, që nga Tok Bahçja, Drenica, Dukagjini, Anamorava, është në varret e ushtarëve të vranë nga ish-Armata Jugosllave. Mos luani me durimin e askujt sepse, ndonëse në një kohë ishim në pozita të kundërta, u treguam të butë dhe kursyem familjet e kriminelëve sepse vlerësuaam dhe vlerësojmë se fëmijët nuk kanë përgjegjësi për veprimet kriminale të paraardhësve të tyre! E keni marrë pushtetin, punoni për shtetin!

## BE-ja e kritikon planin e Trumpit për Izraelin e Palestinën

**BRUKSEL, 4 SHKURT** - Bashkimi Evropian kritikoi të martën planin e presidentit amerikan, Donald Trump për zgjidhjen e konfliktit izraelito-palestinez dhe u shpreh i shqetësuar nga vullneti i Izraelit për të aneksuar Luginën e Jordanit.

“Iniciativa amerikane, si ajo e prezantuar më 28 janar, përjashtoi parametrat e arritur në nivel ndërkombëtar”, u shpreh me keqardhje shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell në një komunikatë. Borrelli udhëton në Uashington

më 7 shkurt.

“Për të ndërtuar një paqe të drejtë dhe afatgjatë, çështjet e pazgjidhura relative me status final duhet të zgjidhen nëpërmjet negociatave të drejtpërdrejta mes dy palëve”, tha shefi i diplomacisë evropiane.



# Paqartësi në shpalljen e rezultateve të demokratëve në Ajova

Procesi i publikimit të rezultateve të mbështetjes nga rrethi i parë zgjedhor në Ajova është futur në kaos, pasi është raportuar për problem teknologjik në procesimin e rezultateve

**WASHINGTON, 4 SHKURT** - Në Ajova të Shteteve të Bashkuara u zhvillua rrethi i parë zgjedhor i cili përcakton mbështetjen për njërin nga kandidatët demokratë që synon nominimin për zgjedhjet presidenciale të nëntorit në ShBA.

Në fakt, votimi në Ajova zhvillohet për zgjedhjen e 41 delegatëve për konventën e Partisë Demokratike e cila mbahet më vonë gjatë këtij viti.

Ngjarja në Ajova është e rëndësishme sepse tregon kahun e mbështetjes së demokratëve për kandidatët potencial për të fituar nominimin.

Mirëpo, procesi i publikimit të rezultateve të mbështetjes është zhytur në kaos, ka njoftuar rfe.

Kjo, pasi është raportuar për problem teknologjik në procesimin e rezultateve.

Partia Demokratike e ka mohuar se bëhet fjalë për “hakim të kompjuterëve ose ndërhyrje”, duke shtuar se bëhet fjalë për rregulla të reja të raportimit të votimeve.

Zëdhënësja e Partisë Demokratike në Ajova, Mandy McClure tha se kanë “gjetur mospërputhje në raportimin e tre grupeve të rezultateve”.

Ajo shtoi se “kjo është thjesht një çështje raportimi, pasi aplikacioni nuk ka rënë nga sis-

temi dhe nuk ka pasur ndërhyrje”.

Pavarësisht mungesës së rezultateve, disa kandidatë për të fituar nominimin e Partisë Demokratike, po pretendojnë kryesimin.

Senatori, Bernie Sanders foli për fitoren e tij, duke përmendur të dhënat e brendshme të fushatës që e vendosën atë përpara Pete Buttigieg, ish-kryebashkiaku i South Bend në Indiana.

Ndërkohë, Buttigieg u citua të ketë thënë se “sipas të gjitha indikacioneve” fushata e tij po shkon drejt fitores në Nju Hampshër.

Ai i është referuar rrethit të parë zgjedhor që do të zhvillohet më 11 shkurt në Nju Hampshër.

Partia Demokratike tha se rezultati do të publikohet më vonë gjatë ditës së martë.

Rezultati mund të ofrojë disa qartësi se cili nga 11 kandidatët për nominimin e demokratëve do të fitojë një nominim në Ajova.

Ky shtet ofron vetëm një numër relativisht të vogël të delegatëve në Kongresin kombëtar të partisë, por demografia e tij - kryesisht e bardhë me votuesit ruralë - është shpesh vendi ku kandidati që garon për Shtëpinë e Bardhë, rrit gjasat e fitores.



Gjatë fushatës zgjedhore, dy çështje kanë qenë përparësi me demokratëve të Ajovas: kujdesi shëndetësor dhe ndryshimet e klimës.

Që nga viti 1996, çdo demokrat që ka fituar mbështetjen e grupeve të Ajovas e ka siguruar nominimin e partisë për zgjedhjet presidenciale të nëntorit.

Sondazhet duket se i japin senatorit të Vermontit, Bernie Sanders një epësi të vogël ndaj tre kandidatëve të tjerë.

Sanders, ish nën-presidenti Joe Biden, senatorja e Masaçusets, Elizabeth Warren dhe ish-

kryetari i South Bend në Indiana, Pete Buttigieg shihen si konkurrentët kryesorë.

Senatori i Minesotës, Amy Klobuchar, sipërmarrësi Andrew Yang, aktivisti miliardier Tom Steyer dhe anëtari i Dhomës së Përfaqësuesve, Tulsi Gabbard mund të kenë ndikim në garë.

Organizimi në Ajova është një sistem i ndërlikuar që ngre tri grupe rezultatesh nga më shumë se 1.600 takime të vogla lokale për të përcaktuar 41 delegatët kombëtarë.

Këtë vit, 41 delegatët për-

fundimtarë do të zgjidhen më 13 qershor në konventën e shtetit.

Në korrik, ata pastaj do të kalojnë në Konventën Kombëtare të Partisë Demokratike, në të cilën delegatët që përfaqësojnë të gjitha shtetet dhe territoret amerikane zgjedhin kandidatin e partisë për zgjedhjet presidenciale.

Dita e zgjedhjeve presidenciale në ShBA është më 3 nëntor. Nga republikanët, sipas të gjitha gjasave, kandidon për rizgjedhje, presidenti aktual i ShBA-së, Donald Trump.

## Borrelli zhvillon bisedime në Iran



**TEHERAN, 4 SHKURT** - Bashkimi Evropian dëshiron ta mbajë të gjallë marrëveshjen bërthamore me Iranin, tha të martën shefi i politikës së jashtme të Unionit, Josep Borrell, raporton Anadolu Agency.

Deklarata e Borrellit erdhi gjatë vizitës së tij në Iran, ku ai u takua me presidentin e vendit, Hassan Rouhani, ministrin e Jashtëm Javad Zarif dhe kryetarin e Parlamentit, Ali Larijani.

“Qëllimi i vizitës është ndërtimi i besimit dhe rritja e stabilitetit dhe sigurisë në rajon pas ngjarjeve tragjike të muajit të kaluar”, tha Borrelli në një konferencë shtypi pas takimeve të tij në kryeqytetin Teheran.

Në fillim të janarit pasoi një konfrontim dramatik midis SHBA-së dhe Iranit pas vrasjes së gjeneralit iranian Qasem Soleimani nga një sulm me dron përpara aeroportit të Bagdadit më 3 janar.

Pas vrasjes, Irani njoftoi se nuk

do të mbështetej më me asnjë angazhim në bazë të marrëveshjes bërthamore të vitit 2015 të nënshkruar me disa fuqi botërore, nga të cilat SHBA-ja u tërhoq në vitin 2018.

Duke vepruar në emër të BE-së, Borrelli aktualisht është një ndërmjetës në proces, i cili mbështetet nga të gjithë ministrat e jashtëm të BE-së.

Shefi i diplomacisë evropiane pranoi se nuk ka zhvillime të fundit lidhur me marrëveshjen bërthamore.

# Meliza dhe Muza e saj, Dy Zonjat M. M.

(Meliza Krasniqi, "Vepra e Musinesë", Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019)

## Kosovare KRASNIQI

Bota, shumë më parë se shqiptarët, ka njohur rëndësinë e gruas dhe rolin e saj në shoqëri, andaj, gruaja bëhet figurë e fuqishme në subjektet e shkrimeve të tyre. Një zë i fuqishëm gruaje që shpaloset para lexuesve të këtij studimi është figura e gruas shqiptare, Musine Kokalari. Musine Kokalari është një nga shkrimtaret e para shqiptare. Ajo ishte rritur mes librash dhe fati i saj ishte paragjykuar të bëhej pioniere grua e letërsisë shqipe. E rrethuar me një ambient egërsisht të bukur siç është Gjirakastra, në mesin e legjendave ku ajo kaloi një pjesë të fëmijërisë dhe rinisë së saj, nga jeta e popullit ajo nxori përshtypjet të cilat më vonë u bënë frymëzim dhe shpirt i veprës së saj letrare. Gjithashtu, problematikat e larmishme që has gruaja shqiptare në jetën e përditshme, vihen në letrën e bardhë të Musine Kokalari. Fakti që shumë nga poezitë e saj i kushtohen gruas shqiptare dëshmon se autorja ka qenë në kontakte me elementë të ndryshëm të kulturës shqiptare. Do të ishte e tepërt të shtoj përshkrimet edhe më të detajuara për jetën dhe veprën e Musinesë. Pena e saj e tërhoqi lexuesin, gjithashtu periudha e shkurtër e krijimtarisë së saj ka zgjuar vëmendjen e kritikëve letrarë.

Kur flasim për personazhin e gruas, dihet se ky personazh në të gjitha epokat është vënë në plan të parë dhe pothuajse në të gjitha gjinitë letrare, mirëpo duke ndjekur zhvillimin e mendimit kritik të studimit në Kosovë, duhet pyetur: "Sa ka ndikuar që gruaja të jetë krijim frymëzues në fushën e studimit"?

## Portreti dhe vepra e Musinesë


Meliza Krasniqi në librin e saj studimor, titulluar "Vepra e Musinesë", ka arritur ta kornizojë portretizimin e një shkrimtareje shqiptare, Musine Kokalari, botën e saj emocionale dhe dekadat e errëta nëpër të cilat kaloi ajo. Musineja në studimin e Melizës nuk është gruaja e letërsisë botërore që u dha pas pasionit për të thyer kode të moralit dhe për të krijuar botëkuptime të reja në

shoqëri, ajo është thjesht një personash grua shqiptare e cila përpiket të shohë përtej asaj çfarë ia kishte ofruar mendësia shqiptare. Ajo është heroina e saj, grua inteligjente, me botë të pasur dhe mbi të gjitha grua që ia njeherë vlerën vetes dhe që nuk pranon të jetë viktimë e sistemit në fuqi. Me një fjalë të thjeshtë, unë do të thosha se Musineja e Melizës është një shpirt i fuqishëm dhe poete origjinale.

Vlera e një studiuesi qëndron në zbulimin e një diçkaje që e veçon shkrimtarin. Falë talentit të saj prej studiuese, modelin që Meliza Krasniqi zgjedh për personazh të saj kryesor është simbol i gjenialitetit intelektual mes grave shqiptare. Në këtë vepër studimore ajo ka paraqitur në mënyrë të thellë e shkencore botën e kësaj poeteje, e cila zgjodhi letërsinë si "një vendstrehim" ku u mbështet edhe në rastet më të rënda. Gjuha e jetës dhe e letërsisë në krijimtarinë e Musinesë kombinohen, prandaj studiuesja Krasniqi shprehet: Gruaja ne poetikën e Kokalari është çfarëdo gruaje e kohës, e cila ilustron e trazuar shpirtërisht dhe e cila jetën e koncepton si dëshpërim, vuajtje dhe mjerim. (Krasniqi 2019: 59).

Poeten Kokalari dhe studiuesen Krasniqi i lidh një subjekt i përbashkët, subjekti në dy rastet është i ushqyer nga figura grua. Kokalari, me një mjeshtri të përsosur të lirikës, ndan dhembjen me fatin e gruas së thjeshtë shqiptare. Lirikat e përfshira në vëllimin me poezi të saj "Kolla e vdekjes" shprehin bukur gjendjen shpirtërore të poetes. Poezitë e saj janë zëri i një shpirti të zymtë dhe vajtues. Meliza analizon në detaje rolin e femrës në poezinë e Musinesë. Gruaja e poezive paraqitet në gjendje shpirtërore të ndryshme dhe përgjatë periudhave të jetës, si vajzë e re, nënë me fëmijë, grua e thjeshtë etj. Prapa subjektit të poezive të saj kërkohet një grua e cila nuk do të rrinte e mbyllur vetëm brenda mureve të shtëpisë, por me fuqinë dhe zërin e saj, mund t'i jepte botës një imazh me më shumë ngjyra.

Në monografinë gjithëpërfshirëse të krijimtarisë së Musinesë, "Vepra e Musinesë" analizohet e gjithë krijimtaria e Musinesë "letrare dhe jo letrare" siç e cek studiuesja Krasniqi. Në dhjetë kapitujt e përfshirë në këtë vepër punimi, ku ndiqet modeli kronologjik i krijimtarisë së Musinesë, ne gjejmë të manifestuar një shkallë të lartë të qartësisë dhe kthjelltësisë së shkrimit. Për librin e saj dhe zotërimin e saj mjeshtëror të përshkrimit studimor e biografik të Musinesë, flet edhe recensuesi i



librit, Gëzim Aliu: Meliza Krasniqi i është qasur veprës së Musinesë përmes gërshtimit të metodave shkencore, nga analiza tekstuale e deri te metoda sociologjike" (Aliu, 2019). Dhe, ne pajtohemi të definojmë faktin se mbi të gjitha veprën në fjalë e shquan trajtimi shkencor.

Shikuar në strukturën e veprës, studiuesja Krasniqi, profilin e poetes Kokalari e ndanë në pesë pamje. Çdo pamje tregon biografinë jetës së saj dhe nëse mund i shtjellojmë në pika të shkurtra, Pamja e parë - familja, tregon familjen, prejardhjen e familjes së saj, në pamjen e dytë - shkollimi, paraqitet shkollimi i saj, nga ku u pajis me një kulturë të shumanshme, bën studime edhe jashtë vendit, pamja e tretë - shoqëria, zbulon shoqërinë e saj, nga ku mësojmë se Musineja është shoqëruar me një varg emrash të njohur të politikës dhe kulturës, te pamja e katërt - letërsia paraqitet esencjalja se si është formuar personaliteti artistik dhe letrar i saj, dhe pamja e pestë, politika, shpalo sakrificën e saj në politikë, dhembjen e saj pas vrasjes së shumë anëtarëve të familjes dhe paraqitet e prirë të merrte vendimet më të rënda. Studiuesja Krasniqi në veprën e saj përfshinë çdo gjë që është esenciale në lidhje me biografinë dhe portretin e saj, përdërisa karakteri i poetes del një grua me vullnet të paepur dhe në secilën pamje tregon guxim, nder, shpresë, krenari, dhembje dhe mëshirë.

Struktura dhe rrjedha e librit

vazhdon me pikëpamjet e studiues Krasniqi, duke u përqendruar në prozën e Musinesë, me ç'rast shprehet se Musine Kokalari shfaqet si fenomen letrar në gjininë e prozës, duke sjellë risi tematike, teknike e stilistike në letërsinë shqipe, pra sjell krijime origjinale (Krasniqi 2019: 67). Studiuesja Meliza Krasniqi më së shumti fokusohet në tri veprat në prozë: Siç me thotë nënua plakë, Rreth vatrës dhe ...sa u tunt jeta. Në rastin e parë, Siç me thotë nënua plakë studiuesja i qaset nga aspekte teorike, duke thënë se tregimi me po të njëjtin titull është tekst që i prin veprës për nga ndërtimi teorik, shfaqja formale e diskursi (Krasniqi 2019: 69). Ndërkaq, "Rreth vatrës" është përmbledhje tregimesh të lidhura të cilat do t'i lexojmë si strukturë e thurur nga tekstet integrale të përrallave dhe formave të tjera orale (Krasniqi 2019 :118), kurse, "...sa u tunt jeta" është roman me karakteristika të veçanta si për kah teknika e krijimit, ashtu edhe për kah ideja, themi se është projekt eksperimentimi me rëndësi të veçantë. Autorja në këtë vepër zgjedh të shkruaj për ceremonialin e dasmës ku mbulohen dhe përfshihen doket, zakonet, ritet, jetesa etj. (Krasniqi 2019: 159-160).

Studiuesja Krasniqi merret edhe me librin e fundit të Musine Kokalari Si lindi partia Social Demokrate, udhëheqëse e së cilës parti ishte vetë Musineja. Libri dëshmon dhe rrëfen karakteristikat e vitit 1937 deri në

lirimin e saj nga burgu në vitin 1961. Kokalari shkruan hollësisht për takimet, diskutimet, vendimet e partisë dhe të vetat personalisht: të gjitha këto ndërtohen përmes kujtesës së saj, tridhjetë e pesë vjet më vonë.

Të një rëndësie të veçantë janë edhe pjesët tjera më të shkurtra të këtij libri studimor si: "Kujtimet", struktura e të cilave nuk është e përcaktuar me ndonjë rregull, janë shkruar në forma të shkëputura dhe të shkurtra. "Letrat", për të cilat studiuesja e Kokalari vlerëson se nuk janë aq intime, por megjithatë ato bartin mjaft shenja autobiografike, ato janë të shkruara në vetën e parë me një diskurs krejt personal. Gjithashtu, në fund të këtij libri, studiuesja Krasniqi shton edhe një skicë të shkurtër mbi kritikën e jetës dhe veprës së poetes së parë shqiptare, ku studiues të ndryshëm të letërsisë shqipe, me studimet e tyre kanë hedhur dritë mbi jetën dhe krijimtarinë e saj.

## Përfundim

Musine Kokalari vdiq nga kanceri i gjirit. Ajo vdiq e vetme dhe e internuar në Rrëshen. Jeta e saj e rëndë është rezultat i asaj që ajo ishte gjykuar si antikomuniste dhe iu desh të paguante shtrenjtë qëndrimin ndaj realitetit. Për një sistem të pandjeshëm ndaj së vërtetës, fjalët dëshmohen si gjëja më e fuqishme në botë. Ishte e qartë se një grua e sinqertë dhe vizionare siç ishte Musineja, ishte e shënjuar nga një sistem i tillë. Ajo nuk u përkul, ajo nuk kishte frikë nga diktatura komuniste. Ishte e vetëdijshme për detyrën dhe për misionin e saj. Gra të tilla mbesin përherë në kujtesën e kombit.


Shikuar nga këndshikimi i studiueses Krasniqi, sa i përket konceptit krijimtarisë së poetes, ajo thotë: Duke vërejtur se lexuesi dhe kritika kanë qëndrime të anshme ndaj figurës së Musinesë, pasivë ndaj veprës dhe aktivë ndaj jetës, jemi munduar që, për lexuesin e ardhshëm të saj, të argumentojmë se Musineja, përveç intelektuale e diplomuar në Romë, me origjinë nga një familje aristokrate, e dashur dhe e respektuar nga intelektualët dhe personalitetet e kohës, e dënua dhe e persekutuar për shkak të politikës, ishte e para shkrimtare grua shqiptare dhe e vetmja deri në vitet 1960 që botoi libër. (Krasniqi 2019: 239).

Studimi i studiueses Meliza Krasniqi mbi krijimtarinë e shkrimtares Musine Kokalari është një ndër të arriturat më të dalluara dhe më me vlerë studimore të kohëve të fundit në botën intelektuale shqiptare.

E jashtëzakonshme

# Për pak sekonda nata u bë ditë, libanezi filmon shpërthimin e meteorit

Një meteor është filmuar me një video amatore duke rënë me shpejtësi të madhe dhe duke shpërthyer gjatë një nate mbi Liban. Pamjet janë filmuar nga Nizar Samir El Murr, 28-vjeçar, i cili në ato çaste ishte në veturë dhe kamera e vendosur në



pasqyrë filmoi këtë moment në Mount Sannine në Liban.

FOTO E DITES



Një shitës i CD-ve shihet duke pritur klientët në stallën e vet në Kabul. /AP/

E rrallë

# 'Instagram'-i ndalon cigaret elektronike

Rrjeti social 'Instagram', ashtu si duhanin dhe armët, ka ndaluar kategorikisht edhe reklamimin e cigares elektronike nga persona me influencë të lartë. Alarmi ndërkombëtar për rritjen e sëmundjeve të mushkërisë si shkak i këtij produkti ka bërë që të ndalohet promovimi i saj. Rrjetet sociale prej disa kohësh kanë ndaluar kategorikisht publikimin e produkteve dhe objekteve të paligjshme që reklamohen nga



persona të zakonshëm apo njerëz të rëndësishëm me influencë të madhe në publik. Pjesë e këtyre produkteve është bërë së fundmi edhe cigarja elektronike.

## BARSOLETA E DITËS



Dy zyrtarë të gjendjes civile, me kontratë shërbyese, shkojnë ta nënshkruajnë listën e pagës:  
- Kamberi, 150 euro. Ndoci, 150 euro. Totali: 300 euro. Ndoci pyet: Kush është ky Totali që nuk e kemi parë kurrë e po marrka pagë sa ne dy bashkë?!



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



#### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



#### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min  
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.  
**Regjia:** J.J. Abrams



#### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.

 <p><b>DASHI</b> Sot do të përballeni me një menaxhim shumë të qetë të angazhimeve. Në punë, në çështje praktike, do të dëshironi të veproni menjëherë.</p>	 <p><b>DEMI</b> Dita e sotme do të jetë e favorshme për realizimin e një dëshire për sa kohë që ju koordinoni çdo detaj të vetëm.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Fakti që sot është dita më me fat për shenjën tuaj, kjo nuk do të thotë se do të shpëtoni nga tranzitimi negativ i Marsit.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Do të ndiheni shumë energjik. Jeta sociale do të ketë një rënie të përkohshme por, nga ana tjetër, raporti me partnerin tuaj do t'ju japë kënaqësi të dyfishtë.</p>	 <p><b>LUANI</b> Do të jetë një e martë fitimprurëse. Mundësi të mira pune, një mjedis i qetë dhe marrëdhënie të mira me kolegët.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Zhvillime interesante do të shfaqen në punë, duhet të jeni të guximshëm! Ju do të jeni në gjendje të përballoni sëmundje të vogla.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Dita e sotme do t'ju lejojë të shihni disa njerëz dhe të rilidhni kontakte interesante. Është koha ideale për një riadhesim me miqtë e vjetër.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Zona sentimentale është në një eksitim të madh, dashuria do të jetë shumë speciale, e kalitru me momente emocionesh intensive.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Në dashuri do të përjetoni një ndjenjë disorientimi, por nuk ka probleme të vërteta: thjesht jeni pak të lodhur.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Relaksohuni dhe vlerësoni gjërat e vogla që ju bëjnë të lumtur çdo ditë. Përkundër kësaj, do të vlerësoheni për angazhimin, qëndrueshmërinë, vazhdimësinë.</p>	 <p><b>UJORI</b> Gjëja e vetme që duhet të bëni është t'i zbërtheni idetë, të bëni kontakte të shkëlqyera dhe të gjeni zgjidhje të zgjuara.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Nëse keni një veprimtari autonome tuajën, mos u merrni më gjëra të tjera që do t'ju konsumojnë. Bëni disa pushime dhe krijoni jetës suaj pak qetësi.</p>

## Tyga ndjek Taynën në 'Instagram'



**R**eperja kosovare Tayna duket se tashmë nuk po pëlqehet vetëm nga publiku shqiptar. Muaj më parë ajo u bë temë e mediave për shkak se futbollisti i njohur i Real Madridit, Vinicius Jr., publikoi një video duke dëgjuar këngën "Sicko", teksa edhe i shkru-


ante në "Instagram". Reperi me famë ndërkombëtare, Tyga, i cili një kohë ka qenë në lidhje me një nga bukuroshet më të ndjekura të 'Instagram'-it, Kylie Jenner, tashmë ka në listën e personave që ndjek në 'Instagram' edhe këngëtarën nga Kosova.

## Neymari fton në festën private Anxhelina Hadërgjonaj dhe Beatrice Ramosaj



**N**uk është hera e parë që dy vajzat shqiptare, Anxhelina dhe Beatrix, janë parë nën shoqërinë e futbollistit të njohur Neymar. Të dielën Neymar organizoi një festë private për 28-vjetorin me miqtë e vet më të mirë në një vend superluksoz të quajtur Palais de Tokyo në Paris. Ai kishte vendosur një kod veshje, ku të gjithë të ftuarit duhet të vinin të veshur me

të bardha. Pjesëmarrës në festë ishin edhe shumë personazhe të tjerë të njohur nga bota e sportit apo e modës. Edhe pse një festë private, fotot nga ditëlindja e tij po qarkullojnë nëpër mediat sociale. Sa i përket Anxhelina Hadërgjonaj dhe Beatrix Ramosaj, ato i kanë kushtuar një rëndësi të madhe pamjes së tyre duke u shfaqur sa më seksi me të bardha.



## Beyonce e Jay-Z shkaktojnë polemika teksa nuk ngrihen në këmbë për himnin

**K**ëngëtarja amerikane Beyonce dhe i shoqi i saj, producenti muzikor Jay-Z, dukej se po mbanin një qëndrim politik në finalen e futbollit amerikan Super Bowl 2020, teksa qëndruan ulur gjatë performancës së himnit kombëtar të ShBA-së. Teksa këngëtarja Demi

Lovato nisi të këndojë në stadiumin Hard Rock të Miamit himnin amerikan 'Flamuri i mbushur me yje', çifti i famshmi i shoubizit dhe bija e tyre Blue Ivy u filmuan në karriget e tyre dhe jo në këmbë siç është zakoni, duke nxitur debate të mëdha në rrjetet sociale.

## Katy Perry shfaqet si zakonisht me stil të veçantë



**A**jo ka punuar për një kohë të gjatë në Hawai për t'i bërë përgatitjet e serisë tjetër të American Idol, shkruan "Daily Mail". Por, këngëtarja e famshme,

Katy Perry, është parë me një stil tejet të veçantë pasi zbriti në aeroportin Heathrow. Superylli ra në sy të turmës pasi kishte veshur një fustan të gjatë me ngjyrë rozë.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# Sport



**QENDRA SPORTIVE**

“BUJQËSIA”

TEL: 045/82 82 82

# Manaj: Jemi gati për pranverë, Trepça '89 nuk bie nga Superliga

Arb Manaj është i bindur se skuadra e Trepçës '89 nuk do të jetë e rrezikuar nga rënia prej Superligës së Kosovës në futboll. “Në sezonin vjeshtor kemi zhvilluar ndeshje shumë të mira dhe po sikur të kishim fat më shumë do të kishim qenë në ndonjë pozitë më lart të tabelë. Kampionati është i gjatë, por kam besim se Trepça '89 do të stabilizohet në tabelë dhe nuk do të rrezikohet nga rënia prej Superligës”, ka thënë Manaj

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 SHKURT - Futbollisti Arb Manaj ka shkëlqyer me fanellën e Trepçës '89 në sezonin vjeshtor dhe kjo bëri që ai të marrë ftesë nga përzgjedhësi i Kosovës, Bernard Challandes, për ndeshjen miqësore me Suedinë. Manaj të martën për “Epokën e re” është shprehur i lumtur për ftesën e fituar që të jetë pjesë e Përfaqësues A, por zotohet se do të punojë edhe më shumë që sërish të marrë ftesë dhe t'i mbrojë ngjyrat e “dardanëve”. “Jam mjaft i kënaqur me ftesën për ndeshjen kundër Suedisë. Kjo më jep motiv edhe më shumë që të punoj dhe të marr sërish ftesë nga Përfaqësuesja, sepse çdo lojtar e ka ëndërr t'i mbrojë ngjyrat e shtetit të vet”, ka deklaruar Manaj, i cili është duke i zhvilluar përgatitjet me Trepçën '89 për sezonin pranveror. Ai ka shtuar se gjeja më e mirë në këto përgatitje ishte moslëndimi i lojtarëve. “Përgatitjet deri tash kanë shkuar mjaft mirë. Fazën e parë e kemi kaluar në Kosovë dhe të dytën në Durrës. Më e mira është se e kemi kaluar pa lëndime dhe Trepça '89 është e gatshme për fillimin e sezonit pranveror”, ka shtuar ai. Më pas ka folur edhe për synimet e klubit nga Mitrovica në këtë kampionat, ku ka paralajmëruar se synim është renditja në një pozitë ku nuk rrezikohet nga rënia prej Superligës. “Në sezonin vjeshtor kemi zhvilluar ndeshje shumë të mira dhe sikurse të kishim fat më shumë do të kishim qenë në ndon-



jë pozitë më lart në tabelë. Kampionati është i gjatë, por kam besim se Trepça '89 do të stabilizohet në tabelë dhe nuk do të rrezikohet nga rënia prej Superligës”, ka thënë Manaj.

Futbollisti i talentuar, Manaj, pas formës së mirë në pjesën e parë të kampionatit, ftesës së Përfaqësues dhe shpalljes në njëmbëdhjetëshin më të mirë të Superligës, në afatin kalimtar të janarit ka marrë disa oferta të rëndësishme, por ai ka vendosur ta respektojë marrëveshjen me Trepçën '89. “Po, kam pasur shumë oferta në janar, por kam

kontratë me Trepçën '89 dhe duhet ta respektoj. Dëshira ime është që të jap kontribut sa më të madh që klubi ta arrijë objektivin në këtë kampionat”, ka pohuar Manaj. Skuadra nga “Riza Lushta” sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e tetë me 23 pikë të grumbulluara, kurse në shtatëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara kjo skuadër ka regjistruar 6 fitore, 5 barazime dhe 6 humbje. Kjo skuadër tashmë është eliminuar edhe nga gara e Kupës së Kosovës dhe të gjitha forcat do t'i fokusojë në sezonin vjeshtor vetëm në Superligë.

SHKURT

## Llapi - Ballkani përfundon miqësisht

Dy skuadrat e IPKO Superligës së Kosovës në futboll, Llapi dhe Ballkani, kanë luajtur baras në miqësoren e zhvilluar të martën në Podujevë (1-1). Pjesa e parë e kësaj ndeshje u mbyll me rezultat 0-0, kurse në minutën e 64-t Llapi kaloi në epërsi me golin e shënuar nga Behar Maliqi, i cili u tregua i saktë nga penalltia. Rezultatin e barazoi Bleon Sekiraqa në minutat shtesë, duke mos lejuar humbjen e kampionëve vjeshtorë të elitës së futbollit të Kosovës.

## Bunjaku, basketbollisti i muajit janar në Superligë

Votat e tifozëve në Federatën e Basketbollit të Kosovës kanë shpallur basketbollistin e muajit janar, fundorin Valon Bunjaku. Basketbollisti i Yllit ka shkëlqyer në muajin që lamë pas duke treguar formë të lartë në paraqitjet e tij. “Valon Bunjaku është shpallur lojtari i muajit janar në votimin e tifozëve në faqen zyrtare në ‘Facebook’. Garat do të vazhdojnë edhe në muajt e ardhshëm, ku në garë do të jenë basketbollistët që zgjedhën MVP të javës”, thuhet në njoftimin e FBK-së. Bunjaku më parë ka luajtur te kampioni dhe fituesi i Kupës së Kosovës, Sigal Prishtina.

## Brightoni i shtohet garës për Muriqin

Pas Tottenhamit, Manchester Unitedit dhe Burnleyt, Vedat Muriqi është duke u monitoruar edhe nga skuadra tjetër angleze, Brighton & Hove Albion. Gazetari i mediumit Haber Global, Yagiz Sabuncoglu, njofton se në ndeshjen e fundjavës ndaj Trabzonsporit, për ta ndjekur Muriqin ishin edhe përfaqësuesit e klubit anglez, Brighton & Hove Albion. Sulmuesi i Kosovës ka kontratë me Fenerbahçen deri në vitin 2023. Ai i ka realizuar 13 gola dhe i ka bërë 5 asistime në 21 ndeshje me Fenerbahçen këtë sezon.

## Lajm i keq për Gjilanin, sërish lëndohet Shameti

Ylli Shameti u transferua në Gjilan në afatin kalimtar të verës, por ish-mbrojtësi i Kukësit nuk mundi dot që të debutojë me skuadrën e re, teksa një dëmtim e la jashtë fushave të blerta për një kohë mjaft të gjatë. Futbollisti 35-vjeçar ishte duke u rikuperuar nga dëmtimi i pësuar, të cilin ishte duke e lënë pas dhe për pak kohë pritej që të vihej nën urdhrat e Mezanit. Por gjërat nuk kanë shkuar edhe aq mirë, teksa Shameti është dëmtuar sërish, këtë herë gjatë fazës së rikuperimit. Kjo pritet ta shtyjë edhe për një tjetër muaj rikthimin e tij në formë të plotë, duke bërë që pritja për debutim me Gjilanin të zgjasë shumë.

## Kujtim Gashi sot ia dorëzon detyrën Vlorë Dumoshit

Prishtinë, 4 shkurt - Sot (e mërkurë) në orën 13:30 do të mbahet ceremonia e pranimit-dorëzimit të detyrës së pozitës së ministrit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës.

“Ish-ministri Kujtim Gashi do t'i dorëzojë detyrën ministres së re Vlorë Dumoshi për ta udhëhequr MKRS-në në këtë mandat qeverisës. Ceremonia do të ndodhë në kabinetin e ministrit në Ministrinë e

Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, thuhet në njoftimin e MKRS-së. Gashi më 11 shtator të vitit 2017 e kishte pranuar detyrën e ministrit të MKRS-së, pikërisht nga Vlorë Dumoshi.





## Mustafi: Do të mendoja për pension, nëse nuk do të besoja në aftësitë e mia

LONDËR, 4 SHKURT - Futbollisti Shkodran Mustafi ka filluar ta rikthejë formën më të mirë dhe trajneri Mikel Arteta është duke i dhënë më shumë hapësirë. Mustafi ka thënë se ai nuk dorëzohet, pasi nëse

nuk do të ishte në gjendje të luante atëherë do të ishte pensionuar. "Ne e dimë se si është futbollit. Ty gjithmonë të jepet mundësia dhe kur e shikon se ti nuk mund të japësh më, atëherë ti mund ta

deklarosh tërheqjen. Megjithatë, një profesionist nuk mund të mendojë në atë mënyrë. Për mua është gjithmonë njësoj, gjithmonë përpiqem t'i lë të gjitha pas krahëve dhe të mendoj vetëm

për skuadrën time. Sa herë që ekipi të ketë nevojë për mua unë do të jem aty jo vetëm në ndeshje, por edhe në stërvitje. Është e lehtë të jesh profesionist kur gjërat shkojnë mirë, por unë mendoj se më e



## Tare: Objektivi ynë është Liga e Kampionëve, për titull mund të ëndërrojmë

ROME, 4 SHKURT - Lazio është duke kaluar një moment të shkëlqyer në Serinë A, duke u shndërruar në një kandidat serioz për titullin kampion, me diferencë -5 pikë nga kryesuesit e Juventusit. Kujtojmë që Lazio ka një ndeshje më pak se bardhezinjtë. Për këtë ecuri fantastike meritë ka padyshim edhe drejtori sportiv Igli Tare, i cili është cilësuar si arkitekti i kësaj skuadre. Pavarësisht se diferenca me kryesuesit nuk është shumë e madhe, shqiptari vazhdon të theksojë se objektivi i klubit është kualifikimi në Ligën e Kampionëve. Në një prononcim për mikrofonin e "Tiki Taka" ai tha: "E jetojmë shumë të qetë javën. Kemi vendosur si objektiv që në fillim të sezonit kualifikimin për në Ligën e Kampionëve. Nëse dikush ka këtë objektiv në fillim të sezonit, atëherë është e qartë se ka një skuadër të fortë. Në këtë moment shumë komponentë po shkojnë



në rrugën e duhur. Puna e jashtëzakonshme e Inzagit dhe stafit të tij, klima shumë e mirë e grupit në dhomat e zveshjes. Por, duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë sepse duhen edhe 17 ndeshje nga fundi i kampionatit dhe gjithçka mund të ndodhë. Fitoret janë shumë të rëndësishme. Për titullin është shpejt të flasim. Rezultatet na

japin mundësinë për të luftuar, por situatat ndryshojnë shpejt. Pastaj, nëse katër apo pesë javë para fundit jemi ende në garë për titullin, do të ëndërrojmë të gjithë së bashku. Ne punojmë çdo ditë dhe shpresojmë të shkojmë sa më shumë të jetë e mundur. Entuziazmi është ndier shumë kohët e fundit, duhet ta ruajmë energjinë pozitive", u shpreh Tare.

## Clippersat mposhtin San Antonion në sekondat e fundit

LOS ANXHELOS, 4 SHKURT - Skuadra e Clippersave ka fituar në sekondat e fundit 108-105 ndaj San Antonios, një ndeshje me rivalitet dhe emocione. "Spurs" pati një avantazh deri në 15 pikë në pjesën e parë (Aldridge 27 pikë e DeRozan 26), por kjo nuk mjaftoi. Për Clippersat u dallua Leonardo me 22 pikë, ndërkohë që 39 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Fitore të lehtë korri Miami, që mundi me rezultat 137-106 Philadelphian, me Jimmy Butler, autor i 38 pikëve, mbështetur nga Dragiq me 24 pikë. Rikthehet te fitorja ekipi i Golden States, që



mundi me rezultat 125-117 Washingtonin jashtë fushe. Beal realizoi 43 pikë për vendësit, por që mbetën për statistikë, ndërsa për miqtë u dallua Burks me 30 pikë. Një ndeshje e mirë për Porzingis që, falë 38 pikëve e 12 reboundeve, i dha fitoren

Dallasit në fushën e Indianas (112-103). Fiton edhe Bostoni, që mundi 123-115 Atlantan, ndeshje ku u dallua Tatum me 28 pikë, ndërsa Memphis fitoi me rezultat 96-82 ndaj Detroitit, me Valanciunas që realizoi 26 pikë e 17 rebounde.

### REZULTATET

Charlotte - Orlando	100-112
Cleveland - New York	134-139
Indiana - Dallas	103-112
Washington - Golden State	117-125
Atlanta - Boston	115-123
Brooklyn - Phoenix	119-97
Miami - Philadelphia	137-106
Memphis - Detroit	96-82
Sacramento - Minnesota	113-109
Clippers - San Antonio	108-105

### SHKURT

#### Ideja e 'çmendur' e tifozëve të Liverpoolit: Trofeun ta ngrehë Gerrardi

Me 24 fitore në 25 takime, Liverpooli po shkon drejt titullit kampion në Angli, pasi tashmë edhe kampionët në fuqi të Manchester Cityt duket se janë dorëzuar, me plot 22 pikë më pak, ndërsa ka mbetur për të ardhur vetëm verdikti matematikor. Ky titull do të vijë pas një periudhe pritjeje prej 30 vjetësh për "The Reds", ndërsa tifozët kanë hedhur një ide mjaft interesante në rjetet sociale, që lidhet me rikthimin e legjendës së Liverpoolit, Steven Gerrard. Ky i fundit arriti të fitojë gjithçka me "The Reds" gjatë viteve të karrierës, por nuk ngriti dot titullin kampion, ndaj tifozët e kuq kanë hedhur idenë që skuadra të nënshkruajë me Gerrardin vetëm për 4-5 javët e fundit me qëllim që ish-kapiteni ta ngrehë titullin kampion në fund të sezonit. Aktualisht kemi të bëjmë vetëm me një ide të tifozëve, për të cilën ende nuk është shprehur trajneri Jurgen Klopp, por as vetë Gerrardi, pasi që ky i fundit t'i bashkohet Liverpoolit në javët e fundit, duhet të japë dorëheqje për disa javë nga bankina e Rangersit në Skoci.

#### Leno: E dija se Xhaka dhe Aubameyang nuk do të largoheshin

Portieri i Arsenalit, Bernd Leno, ka thënë se asnjëherë nuk është frikësuar se nga skuadra do të largohen Granit Xhaka dhe Pierre Emerick Aubameyang. Sulmuesi Aubameyang lidhej me një transferim të Barcelonës, kurse Xhakën e dëshironte Hertha Berlin. "Sigurisht, ka shumë thashetheme dhe njerëzit flasin për këto gjëra. Por, kurrë nuk ishte ndjenja se ndonjë lojtar po mendonte për një skuadër tjetër, ose dëshironte të largohej, refuzonte të stërvitej ose nuk kishin fokusin te stërvitja. Të gjithë mund të shohin se kemi trajner të ri dhe një mentalitet të ri. Ne duam të ndërtojmë diçka këtu tek Arsenalit", ka thënë Leno.

#### Rikthehet Hazardi

Eden Hazard para dhjetë javësh pësoi një lëndim në këmbë kundër Paris Saint-Germain dhe tash është gati të rikthehet në aksion për Real Madridin. Duke mos arritur të rikuperohet në kohë për të luajtur të shtunën në La Liga derbin ndaj Atletico Madridit, belgu duket se do të rikthehet të enjten në përballjen e Kupës së Mbretit ndaj Real Sociedadit.

#### Chelsea mendon ta zëvendësojë Kepan me Musson

Skuadra e Chelseat më 8 gusht të 2018-s pagoi shifrën prej 80 milionë eurove për Kepa Arrizabalaga, i cili u bë portieri më i shtrenjtë në historinë e futbollit. 25-vjeçari nuk po ka paraqitje stabile, për çka është kritikuar shpesh edhe nga Frank Lampard, kurse në ndeshjen e fundit ndaj Leicesterit portieri u la në bankën rezervë. Chelsea po synon shitjen e Kepas dhe blerjen e portierit të Udineses, Juan Musso.

#### Coronavirusi në Kinë, gati shkëmbimi i garave me një tjetër pistë

Gara e Çmimit të Madh të Kinës në Formula 1, e planifikuar më 19 prill të këtij viti, mund të zhvillohet më 27 shtator (pas garës së Singaporit). Organizatorët e garës kineze, që zhvillohet në Shanghai, kanë nisur bisedimet me organizatorët e garës së Çmimit të Madh të Ruisë, që zhvillohet në Sochi, për t'i shkëmbyer datat e zhvillimit të garave. Kjo ide për të shkëmbyer data pritet të konkretizohet ditë në vijim. Ajo vjen për shkak të coronavirusit që ka "pushtuar" Kinën, duke e vënë në dyshim garën në shtetin aziatik. Edhe Liberty Media, kompania që zotëron aksionet e Formula 1, është dakord me këtë shkëmbim datash mes Kinës dhe Ruisë dhe ka nisur të ndërmjetësojë që gjithçka të mbyllet sa më shpejt.



<b>EPOKA E RE</b>		<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	I PAMBARUAR, I PAPER-FUNDUAR	ALEANCA	FUTBOLLISTI ANGLEZ LENON	POSEDOJ DIÇKA	PARAPAGUES	UDHËHEQËSI I NJË ORGANIZATE	PËREMËR PRONOR	PJESËTAR I NJË POPULLI NË SRI LANKË	ZANORE	RASIM KIÇINA	<b>EPOKA E RE</b>
		QË NUK ËSHTË I KALITUR											KËNGËTARI ERION
		BIMË PARAARDHËSE									KUVENDI KOMUNAL IRMA LIBOHOVA		
		PËRSHTATJA										ZANORE I ZURE ME DORË	
		KNOËLEDGE TRANSFER NETËORK				NORVEGJIA, ESTONIA DRITËSHKURTER			AKTORI REXHEPI KULAÇE (shq.)				
		RENS ISTVUD			AKTORJA E FAMSHME ..... STRIP ZVOGËLIM I TEPËRT (sh.shq.)						KUDRET ISAI PJESA E SIPËRME QË MBYLL A MBU-LON NJË ENË		
		ZANORE		VËNIE E MINAVE BASHKËT.						ISH PORTIER OLIVER ... KËSTI BANKAR			
		KONGRESM-ENI ..... ENGEL						LETRARI FATOS ..... MODELJA KANADEZE XHESIKA (shq.)					
<b>EPOKA E RE</b>	PAVLEFSH-MËRI (jur.)		AFTËSIA E PAGIMIT (treg.) DUKURI E RE	TONELATË	BASKETBOLLISTI AMERIKAN SHEKIL ....	BASHKËT. NAIM ISMAJLI	NDËRMARRJA PRIVATE DEM		KULMARE PARA TË NËNTËS				SHTERPE
		AKTORI AMERIKAN NË FOTO EDËARD					TITAN			E FRIKË-SOVA QË ËSHTË ME TINGUJ TË ÇRREGULLUAR			BASHKËT. U THA
		LIDHJA, SHOQATA					E PESHOVA FRYMA			QË DO ZGJIDHJE SHUMË TË SHPEJT FEMRA LUFTËTARE (mit. greke)			
		LISNAJË, PYLL ME LISA			SKUQJA E LWKURWS NGA ZGJERIMI I KAPILARWVE PATRIOTI RRUSTEMI						VEGËL MUZIKORE KATËR (romak)		
		INTENSITET, TITAN		DAFINË TRUP QIELLOR			PREMTIMI QË JEPET PËR TË BËRË DIÇKA NOTË MUZIKORE					ERBIUM LIDHJA E ZHIVËS ME NJË METAL TJETËR	
		"TETOVA"		BASHKËT. QË KA TË BËJË ME ATA-VIZMIN	AKTORJA MUÇOLLI OLIVER NEUVILLE					DËMTIM I NJË MAKINE GJATË KOHËS SË PUNËS KRYEMURGU			
		KALIBËR I TYTËS SË ARMËS			GURRA KANDËRR E VOGËL DHE E ZEZË QË BREN DRURIN			ADEM ZAJMI INSTITUCION I LARTË SHKENCOR			SHKRONJA XVIII RAMADAN AVDIU		BASHKËT. EMËRTIM I PËRCAKTUAR MIRË DHE I PËRPIKTË I NJË NOCIONI
		SHUMË I MADH DHE I FUQISHËM					PËRPUNIM I HOLLËSISHËM I NJË PROJE-KTI (sh.pashq.) PËREMËR PRONOR						
<b>EPOKA E RE</b>	DAULLJA	KYÇ GYP NËPËR TË CILËT KALON GJAKU (shq.)		PROFESIONI	TËRËSI E VEPRIMEVE TË NJË KULTI FETAR			HENDEK PËR TË UJITUR (sh.pashq.) PASIM (sport)					I AFROVA (bised.)
		FUTBOLLISTI ARGJENTINAS KARLOS			INVA MULA SECILA NGA TRAJTAT E NDRYSHME QË MERR EMRI		SHPEND ME QAFË TË GJATË LLOJ BUKE				I HIRTË; I PËRHIMËT GJAKATAR		
		I NJËSUAR, I BASHKUAR			SHKRIMTARI ..... MEKULI (shq.) BASHKËT.					THIKA QË MBAHEJ SI ARMË BREZI "A" para dy "S"			
		EURO - DEPUTETJA GJERMANE DORIS ...		SHEGË PYLL			KAMPIONE MOLDAVIA			AUTOMOBILE ASSOCIATION MALAYSIA NJËSI PESHE (vjet.)			BASHKËT. RRALLË (Lat.)
		ZANORE	AFËRDITA DRESHAJ	MUNICIPAL ART SOCIETY VLORA OSMANI		MIMOZA MUSTAFA TEDI ARBELOA		QYTET NË BOSNJË DHE HERCEGOVINË NOTË MUZIKORE					
		ANIJATAT				FUTBOLLISTI YNË EMRA (shq.) BASHKËT.						ARTIOLA TOSKA ZANORE	
		IDHULLI				LECKA PËR ARNIM			ZANOE		VEGËL MUZIKORE E PËRDORUR QË NË KOHË TË LASHTA		

ZGJIDHJA E FALËKËRKYQIT: I PAKALITUR, PARABIMA, KK, AKOMODIMI, O, KTN, NE, ILIR, RI, MERIL, KI, Y, MINIM, KAN, ELIOT, ARAPI, R, NP, SKAPE, NORTON, TI, E TUTA, S, UNIONI, E MATË, AKUT, LISNI, ERITEMA, UTE, ITI, LAR, ZOTIMI, ER, TE, P, VALINA, AVARI, ETALON, AMA, AZ, M, L, TITANIK, ELABORATË, AN, RIT, KANALE, TEVEZ, IM, PATË, GRI, UNITAR, ESADI, KAMA, PAK, NAR, ASE, AAM, V, A, MAS, MM, MOSTARIM NAVATAT, ULIKSI, AT, DOLI, ARNA, A, LIRA.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas  
Municipality  
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/89  
Më: 04/02/2020  
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, neni 6 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komonale për Arsim në Dragash, shpall:

#### KONKURS-përsëritet

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët të Komunitetit të Dragashit për vitin shkollor 2019/2020.

#### SHFMU " Ilmi Bahtjari"- Blaç

1. Një edukatore për mësimin parafillor në paralelen e ndarë në Zgatar

#### SHFMU " Sezai Surroi"- Bellobrad

1. Një edukatore për mësimin parafillor në paralelen e ndarë në Zym (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lëshonës)
2. Një mësimdhënëse për Gjuhë Gjermane (10 orë)

#### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

Formulari i aplikimit (merrret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.), Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës), Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj, Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar, Certifikata që nuk jeni nën hetime, Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Konkursi mbetet i hapur **8 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

**Vërejtje:** Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë:04.02.2020  
Dragash

Drejtori i DKA-së  
MSc. Vloran Cenaj



Administrata Tatimore e Kosovës  
Poreska Administracija Kosova  
Tax Administration of Kosovo

## ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS Organizon

# SEMINAR

## PËR TATIMPAGUES

#### TEMA:

- Risitë në Administratën Tatimore të Kosovës
- Aplikimi i ngarkesës së kundërt për TVSH në ndërtimtari
- Deklarimi vjetor PD, CD dhe DO
- Risitë sipas Ligjit të Ri për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim

#### SEMINARI MBAHET:

Data	Regjioni	Ora	Vendndodhja
11.02.2020	Prizren	10:30	Salla në Hotel "City", Prizren
12.02.2020	Ferizaj	10:00	Salla e Kuvendit Komunal në Ferizaj
14.02.2020	Gjakovë	10:30	Salla e Kuvendit Komunal në Gjakovë
19.02.2020	Mitrovicë	10:00	Salla e trajnimeve në ATK, Mitrovicë
20.02.2020	Prishtinë	10:00	Hotel "EMERALD" në Prishtinë
21.02.2020	Gjilan	10:00	Salla e Kuvendit Komunal në Gjilan
25.02.2020	Pejë	10:30	Salla e Kuvendit Komunal në Pejë

Në këto seminare ftohen të marrin pjesë tatimpaguesit (organizata biznesi, OJQ apo përfaqësues të tyre), përfaqësues të njësive të përhershme, kontabilistë dhe qytetarë të interesuar me qëllim që të informohen për: Risitë në ATK; Trajtimin tatimor për aspekte të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për aplikimin e Ngarkesës së kundërt të TVSH-së për shërbimet në lëminë e ndërtimit sipas Vendimit Shpjegues Publik Nr. 03/2019; Deklarimin vjetor për Bizneset e Mëdha Individuale, Korporatat e Mëdha dhe Ortakëritë. Po ashtu, gjatë këtyre seminareve, tatimpaguesit do të informohen për të gjitha risitë sipas Ligjit të Ri për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

#### Për informata tjera kontaktoni:

Tel.: 038/200-250 17,  
e-mail: [info@atk-ks.org](mailto:info@atk-ks.org)  
web: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas  
Municipality  
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/90  
Më: 04/02/2020  
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komonale për Arsim në Dragash, shpall:

#### KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët të Komunitetit të Dragashit për vitin shkollor 2019/2020.

#### SHFMU "Fctah Sylejmani" Dragash

- Mësimi në gjuhën boshnjake
1. Një mësimdhënëse për Gjuhë Angleze (10 orë)

#### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

Formulari i aplikimit (merrret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.), Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës), Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj, Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar, Certifikata që nuk jeni nën hetime, Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

**Vërejtje:** Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë:04.02.2020  
Dragash

Drejtori i DKA-së  
MSc. Vloran Cenaj



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-MINISTARSTVO  
ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

## NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURSIT

Bazuar në Rekomandimin e datës 04.02.2020, me Nr. të Protokollit 463/2020, të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, KPSHC, për pozitën, Zyrtar i Lartë Ligjor në Divizionin për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bënë njoftimin për anulimin e konkursit të shpallur me datë 04.09.2019, me Nr. të Ref. 59/2019, për pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor.

## OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Na osnovu Preporuke dana 04.02.2020, sa Brojem Protokola Br. 463/2020, Izborna Komisija Civilne Službe, SKCS, za radno mesto Viši Pravni Službenik u Diviziji, Za Izradu I Uslakdivanje Zakonodastva, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, objavljuje anuliranje konkursa objavljenog dana 04.09.2019, sa brojem Ref. Br. 59/2019, za radno mesto Višeg Pravnog Službenika.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

INr. 464-60849  
Datë: 03.02.2020

Në bazë të dispozitave të neneve 11,13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28 Tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91), të dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 datë 26.09.2008, Vendimit të Kuvendit Komunal Lipjan 15Nr.464-70930 datë 31.10.2019 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmerive, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

I. MIRATOHET, shpronësimi shtesë i pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale Lipjan, Banullë dhe Gllgovc sipas Listës së bashkangjitur të këtij Vendimi, për arritjen e qëllimit dhe përfitimit të ligjshëm publik, për ndërtimin-asfaltimin e rrugëve "Bejtush Gërbeshi" dhe "Qamil Olluri" në Lipjan, me Vendimin e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit 15Nr.464-70930 datë 31.10.2019 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmerive sipas projektit për ndërtimin-asfaltimin e rrugëve "Bejtush Gërbeshi" dhe "Qamil Olluri" në Lipjan.

II. Obligohet Zyra e Kryetarit-Sektorit pronësoro-juridik që brenda pesë (5) ditëve të punës t'u dërgojë Vendimin Përfundimtar personave të identifikuar në këtë Vendim.

III. Pjesë e këtij Vendimi është akti i vlerësimit në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata Pronar apo Zotërues të Interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i shpronësimit.

IV. Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, që brenda afatit prej dy (2) viteve të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar sipas raportit të vlerësimit të Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës.

V. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Përfundimtar, Zyra e Kryetarit e shpall Vendimin në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

VI. Kundër këtij Vendimi brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Themelore Prishtinë-dega në Lipjan çdo person i cili është Pronar ose Zotërues i Interesit në pronën ose të drejtat pronësore të prekura nga Vendimi Përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit në përputhje me nenin 36 dhe 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28 Tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91).

VII. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektorit pronësoro-juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Shërbime Publike.

VIII. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtorati për gjeodezi dhe Kadastër është i obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

IX. Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërin nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.

Iu dërgohet:

- Pronarëve ose Zotëruesëve të Interesit
- Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorati për Buxhet dhe Financa
- Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër
- Drejtorati për Shërbime Publike
- Arkivit të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti



Përshkrimi detaj i parcelave kadastrale sipas Certifikatës-Njesisë kadastrale

Nr.	Pronar	K.K. Lipjan			K.K. Lipjan				
		Parcela kadastrale	Kultur a-klasa	Sipërfaqe m <sup>2</sup>	Gjendja e re	Parcela kadastrale	Kultur a-klasa	Sipërfaqe mbetur m <sup>2</sup>	Vendim Përfundimtar INr.464-23129/1 dt. 21.11.2018 Sipërfaqe për rrugë m <sup>2</sup>
1	Afrim Lekiqi (Mehdi)	1353-0 ZK Lpjan	Arë e kl.1	302	Gjerëtanishmi	E re	204		
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	35	63
2	Afrim Lekiqi (Mehdi)	1354-2 ZK Lpjan	Arë e kl.1	168	Gjerëtanishmi	E re	129.14	14	25
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		
3	Afrim Lekiqi (Mehdi)	1354-1 ZK Lpjan	Arë e kl.1	169	Gjerëtanishmi	E re	138	11	20
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		
